



KOMUNA E GJILANIT

**PROGRAMI QEVERISËS 2018+  
OBJEKTIVAT STRATEGJIKE PËR GJILANIN  
ZHVILLIMOR**

**-PLANI I PUNËS-  
2019 +**

# HYRJE

## RISHIKIMI STRATEGJIK I PROGRAMIT QEVERISËS TË GJILANIT

Gjilani është një nga shtatë qytetet më të mëdha të Kosovës. Është vendosur në fushën e Gjilanit gjegjësisht në jug-lindje të Kosovës në Anamoravë. Ndërsa hapësira e komunës shtrihet në 392 km<sup>2</sup> dhe përbëhet prej 42 zonave kadastrale.

Popullsia e Gjilanit, përherë ka qenë e përzier, por me një shumicë dominuese të



shqiptarëve, si gjatë sundimit turk, ashtu edhe atij serbo-jugosllav. Sipas regjistrimit të vitit 2011, komuna e Gjilanit ka 90.178 banorë, shqiptarë – 87.814, turq – 978, serbë – 624, boshnjakë – 121, romë – 361, ashkali – 15, goranë – 69, të tjerë – 96.

Në qytet jetojnë 54.239 banorë, kurse në zonat rurale – 35.939. ndarja e popullsisë sipas gjinisë: meshkuj – 45.354, femra – 44.824.

Komuna e Gjilanit është e përkushtuar në qeverisje të mirë, që nënkupton shërbim ndaj qytetarëve të Gjilanit. Për këtë Kryetari Lutfi Haziri është zotuar se do t'i qojë deri në fund premtimet e tij për ta ndryshuar jetën e qytetarëve të Gjilanit.

“Unë dhe këshilltarët komunalë kemi vetëm një detyrë dhe ajo është që t’iu shërbejmë qytetarëve me dinjitet dhe sa më mirë” – është motoja e qeverisjes së tij.

Vizioni i tij është një administratë digjitale efiçente, shërbime të mira shëndetësore, arsimimin cilësor, bujqësi të zhvilluar, infrastrukturë moderne.

Ky dokument do të shërbejë si një lloj programi i rishikuar e themeltar i qeverisjes së Komunës së Gjilanit, në bazë të së cilit do të mund të realizohej edhe një vlerësim adekuat dhe i duhur për të gjithë bartësit e ekzekutivit, në kohën e duhur dhe sipas përcaktimit të Kryetarit të Komunës si autoriteti më i lartë ekzekutiv dhe përfaqësues i Gjilanit. Këtu janë përfshirë edhe aktivitet kryesore të të gjitha drejtorive komunale në kuadër të Planit të Punës 2019.

# RISHIKIM I PLANIT DINAMIK TË PUNËS PËR VITIN 2018

## PROGRAMI PËR GJILANIN 2017+

Plani i Punës për vitin 2018 dhe secilin vit të kësaj qeverisje lokale buron nga Programi Qeverisës për Gjilanin, i cili bazohet në Programin Elektoral të Kryetarit Haziri vitit 2017. “Programi Elektoral për Gjilanin 2017+” është dokumenti themeltar strategjik që i jep frymë qeverisjes lokale në Gjilan.

Andaj, në kuadër të këtij programi, Plani i Punës për Qeverisjen Lokale në Gjilan, parasheh këtë vizion zhvillimor për Komunën e Gjilanit:

*“Gjilani, në të cilën vazhdimisht forcohet demokracia qytetare, sundon ligji dhe respektohen të drejtat e njeriut, promovohet mirëqenia e qytetarit dhe zhvillimi ekonomik nëpërmjet ofrimit të mundësive të barabarta, stimulohet tregu i hapur dhe lëvizja e lirë e qytetarëve dhe e ideve, mbështetur në arsim cilësor e modern dhe në shoqëri të dijes, në të cilën respektohen vlerat dhe traditat e qytetarit të Kosovës.”*

Plani i Punës për Qeverisjen në Gjilan përmban parimet mbi të cilat mbështetet filozofia e veprimit politik të punës në ekip dhe suksesit të vazhdueshëm. Këto parime janë frymëzuar nga vlerat dhe përvoja politike në qeverisje, nga nevojat, prioritetet dhe interesat lokale dhe nacionale si dhe nga parimet gjenerale të Partive Popullore Evropiane.

Ky program është punuar me pjesëmarrjen e gjerë të shumë ekspertëve dhe të diskutimeve në kuadër të konventave programore në të cilat kanë marrë pjesë shumë ekspertë të fushave të ndryshme. Programi reflekton plotësisht nevojat e qytetarëve të komunës së Gjilanit të identifikuara nga shumë takime që janë bërë në të gjitha lokalitetet e komunës. Si i tillë, ky program është real, përmbajtjesor dhe bazohet në gjendjen aktuale dhe objektivat zhvillimore të komunës.

Programi gjithashtu parasheh mekanizmat për t’u adaptuar ndaj ndryshimeve që mund të ndodhin gjatë katër viteve të qeverisjes komunale.

Ashtu si është përgatitur me involvimin e gjerë të qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit në komunë, ky program, tanimë në vitin e parë të zbatimit, po realizohet përmes

një pjesëmarrje aktive të qytetarëve në definimin e prioriteteve afatshkurtëra dhe më konkretisht realizimit të projekteve zhvillimore në baza vjetore.

Përfundimisht, ky program hedhë në pah Objektivat Strategjike për Gjilanin Zhvillimor, ndërhyjnë aty ku nevojat janë identifikuar tanimë dhe çon drejtë realizimit të vizionit për Gjilanin.

Në vazhdë të zbatimit të vizionit për Gjilanin që është bazament i qeverisjes së tanishme lokale, objektivat strategjike janë këto:

- Objektivi 1** Gjilani, një vend i dëshirueshëm për të jetuar, për të punuar dhe për të mbajtur familjen.
- Objektivi 2** Të përgjegjshëm ndaj nevojave të qytetarëve, në rritjen e nivelit të kënaqshmërisë së qytetarëve me ofrimin e shërbimeve dhe informim publik cilësor.
- Objektivi 3** Promovimi dhe përmirësimi i ambientit të Gjilanit si qytet lider për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve ekzistuese, zgjerimin e tyre si dhe për ato të reja.
- Objektivi 4** Edukim të dinjitetshëm të brezave të rinj duke iu ofruar mësimdhënie dhe mësimnxënie kualitative bashkëkohore, mjedis të përshtatshëm mësimor me infrastrukturë adekuate dhe gjithë përfshirëse;
- Objektivi 5** Sigurimi i një buxheti të balancuar për një periudhë 10 vjeçare të planifikimit me rezerva dhe fonde adekuate për zëvendësim dhe mirëmbajtje të objekteve dhe pajisjeve.
- Objektivi 6** Rritja dhe përmirësimi i kushteve të banimit me mundësi të ofrimit të opsioneve të ndryshme për banim – strehim.
- Objektivi 7** Ofrimi i ambienteve për rekreacion, ngjarjeve kulturore dhe programe për t'i përmbushur nevojat e qytetarëve të të gjitha moshave me theks të veçantë në mirëqenien e rinisë.
- Objektivi 8** Krijimi dhe mirëmbajtja e sistemit të sigurtë dhe efikas të qarkullimit në trafik.
- Objektivi 9** Bërja e Gjilanit një qytet të sigurtë, ashtu që qytetarët dhe vizitorët e tij të ndjehen të sigurtë në shtëpitë e tyre, shkolla, në vendet e punës dhe në gjithë qytetin.
- Objektivi 10** Shtimi dhe mirëmbajtja e parqeve, hapësirave publike, objekteve rekreative, rrugëve, ndërtesave dhe infrastrukturës tjetër me qëllim të arritjes së standardeve të larta të dukjes dhe gjendjes së tyre.
- Objektivi 11** Zhvillimi i Gjilanit në përputhje me planet zhvillimore komunale dhe menaxhimi i burimeve fizike bazuar mbi parimet e shëndosha mjedisore.

Sikur që parashohin këto objektiva, në kuadër të Programit të Punës për Qeverisjen Lokale në Gjilan janë paraparë edhe *Vlerat e Qeverisjes*, të cilat gjithësesi duhet të reflektojnë edhe në Planin Dinamik të Punës që tanimë veç është në zbatim. *Vlerat e Qeverisjes* siç janë proklamuar edhe më herët janë:

**Integriteti dhe besimi** – Ne e mendojmë atë që e themi dhe nderojmë fjalën tonë duke u angazhuar në mbajtjen e premtimeve tona. Ne e vlerësojmë dhe jemi të denjë për besimin e ndërsjellë, sepse ne besojmë në Zot dhe në familje e atdhe.

**Përkushtim për shërbime** – Vendosja e qytetarit në rend të parë, trajtimi me mirësjellje dhe respekt duke e këshilluar dhe ndihmuar në zgjidhjen e problemeve.

**Partneriteti** – Rëndësia e veçantë në ndërtimin e partneriteteve me qytetarët në sigurimin e të kuptuarit të nevojave të tyre në ofrimin e shërbimeve në mënyrën më efektive të mundshme.

**Inovacioni dhe përmirësimi i vazhdueshëm** – Përpjekja për përsosmëri në cilësinë dhe produktivitetin e punës sonë. Ne krijojmë mjedis pune në të cilin kërkojmë dhe hulumtojmë për zgjidhje të reja në ofrimin e shërbimeve kualitative. Ne e njohim nevojën për të qenë dinamik në përmbushjen e kërkesave të qytetarëve për ndryshime. Secilit të punësuar do t'i japim mundësi që të zhvillohet dhe të përparojë.

**Performanca dhe Llogaridhënia** – Përcaktimi i objektivave të matshme të performancës të cilat do t'i mbështesin prioritetet e komunës. Do të sigurojmë autoritetin e nevojshëm, trajnimet dhe resurset që na mundësojnë arritjen e qëllimeve tona të përbashkëta. Matja e performancës bëhet në mënyrë periodike dhe efektive. Avancimi i të punësuarve dhe stimulimet tjera bazohen në performancën e tyre. Ne jemi krenarë për profesionalizmin, kompetencën dhe dedikimin që ekziston në ekipin tonë qeverisës.

**Planifikimi afatgjatë** - Ne zhvillojmë planifikim strategjik dhe financiar afatgjatë, për të maksimizuar dhënien e shërbimeve dhe ndërtimin e stabilitetit ekonomik. Ne praktikojmë menaxhim të shëndoshë fiskal për të mbrojtur resurset publike.

**Puna ekipore** – Ne do të respektojmë secilin individ dhe do t'i kushtojmë kohën e duhur të përkushtimit. Të gjithë të punësuarit do t'i trajtojmë me konsideratë të njëjtë dhe do t'ju kushtojmë vëmendje të plotë. Ne vlerësojmë partneritetin ndërmjet të punësuarve si diçka thelbësore me qëllim të maksimalizimit të burimeve në ofrimin e shërbimeve kualitative.

**Vlera e individit dhe diversiteti** - Ne njohim dhe vlerësojmë veçantinë e çdo individit. Ne vlerësojmë kontributin e dhënë dhe sinergjinë e krijuar nga përvoja dhe perspektiva të ndryshme, ne veçanti qytetarët tanë në mërgatë. Ne jemi të përkushtuar për të trajtuar çdo qytetarë me respekt dhe dinjitet.

Ky dokument i Rishikimit Strategjik, pos që hedh në pah këto vlera të qeverisjes dhe objektivat strategjike të qeverisjes lokale në Gjilan, ka për synim që të njëjtat t'i vë në funksion të Planit Dinamik të Punës për vitin 2018, si element konstituiv i Programit të Punës për Qeverisjen Lokale për Komunën e Gjilanit në këtë mandat.

Diskutimi i Planit Dinamik të Punës është bërë me qëllim të riorganizimit strategjik të programit të punës për vitin 2018, duke vënë theksin mbi llogaridhënien dhe përgjegjësinë. Në kuadër të këtyre dy attributeve, esencialisht të rëndësishme për qeverisje të mirë, Plani Dinamik i Punës tanimë i rishikuar, ka përcaktuar jo vetëm përgjegjësitë për punët e projektet e caktuara, por edhe afatet kohore gjatë së cilave duhet përfunduar të njëjtat.

Po ashtu, siç është elaboruar shkurtimisht edhe më lartë, ky Plan Dinamik i Punës shprehimisht ndërlidhë edhe vlerat e qeverisjes dhe objektivat strategjike të dala nga programi elektoral fitues në komunën tonë.

Para se të paraqesim në mënyrë tabelare Planin Dinamik të Punës, po ndajmë këtu edhe objektivat kyçe për sektorët kryesorë të qeverisjes komunale:

### **ARSIMI**

*Edukim të dinjitetshëm të brezave të rinj duke iu ofruar mësimdhënie dhe mësimnxënie kualitative bashkëkohore, mjedis të përshtatshëm mësimor me infrastrukturë adekuate dhe gjithë përfshirëse*

### **SHËNDETËSI, MIRËQENIE SOCIALE, BANIM DHE ÇËSHTJE TË VETERANËVE**

*Rritja dhe përmirësimi i kushteve të banimit me mundësi të ofrimit të opsioneve të ndryshme për banim – strehim.*

*Të përgjegjshëm ndaj nevojave të të gjithë qytetarëve (e në veçanti të veteranëve, invalidëve dhe atyre me nevoja të veçanta), në rritjen e nivelit të kënaqshmërisë së qytetarëve me ofrimin e shërbimeve dhe informim publik cilësor.*

*Gjilani, një vend i dëshirueshëm për të jetuar, për të punuar dhe për të mbajtur familjen.*

### **ZHVILLIM EKONOMIK, FINANCAT DHE BUJQËSIA**

*Promovimi dhe përmirësimi i ambientit të Gjilanit si qytet lider për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve ekzistuese, zgjerimin e tyre si dhe për ato të reja – me fokus të veçantë për agrobiznesin.*

### **SHËRBIME PUBLIKE, PLANIFIKIM URBAN DHE EMERGJENCA**

*Zhvillimi i Gjilanit në përputhje me planet zhvillimore komunale dhe menaxhimi i burimeve fizike bazuar mbi parimet e shëndosha mjedisore si dhe mbi parimet e partneritetit me mekanizma vendor e ndërkombëtar, të cilat ndihmojnë në arritjen e vizionit për komunë model me një qeverisje kualitative, efikase dhe llogaridhënëse.*

*Sigurimi i një buxheti të balancuar për një periudhë 10 vjeçare të planifikimit me rezerva*

*dhe fonde adekuate për zëvendësim dhe mirëmbajtje të objekteve dhe pajisjeve. Krijimi dhe mirëmbajtja e sistemit të sigurtë dhe efikas të qarkullimit në trafik.*

## **KULTURË, RINI DHE SPORT**

*Ofrimi i ambienteve për rekreacion, ngjarjeve kulturore dhe programe për t'i përmbushur nevojat e qytetarëve të të gjitha moshave me theks të veçantë në mirëqenien e rinisë. Shtimi dhe mirëmbajtja e parqeve, hapësirave publike, objekteve rekreative e kulturore, rrugëve, ndërtesave dhe infrastrukturës tjetër me qëllim të arritjes së standardeve të larta të dukjes dhe gjendjes së tyre.*

Plani Dinamik i Punës, siç është paraqitur më poshtë, përcakton detyrat, projektet dhe programet që kanë filluar dhe vazhdojnë të implementohen në vitin 2018, si dhe njëkohësisht liston të gjithë zyrtarët përgjegjës për mbarëvajtjen e punimeve për secilën pikë. Gjatë diskutimeve të punëtorisë, ky Plan Dinamik i Punës, tanimë ka marrë edhe dimensionin kohor që përcakton afatet kohore për kryerjen e punimeve apo përfundimin e projekteve të caktuara. Personat përgjegjës obligohen që për çfarëdo shtyrje eventuale të afatit kohor të përfundimit të punëve, apo mos përmbajtje ndaj të njëjtës, të raportojnë me shkrim tek Kryetari i Komunës.

Ndryshimet eventuale, për arsyeje kuptimplota, apo për shkak të "force majore" apo faktoreve të jashtëm, do të harmonizohen me Kryetarin e Komunës si dhe ekipin përgjegjës për implementimin e tërësishëm të këtij plani.

# PROPOZIMET PËR PROJEKTE KAPITALE E STRATEGJIKE PËR GJILANIN

## IDENTITETI I QEVERISJES SË GJILANIT 2018+

Përkundër të gjitha sfidave, plani i qeverisjes së Gjilanit në krye me Lutfi Hazirin si Kryetar Komune, do t'i jep identitet të veçantë qeverisjes lokale në Gjilan. Në këtë kontekst, Gjilani përtej të qenurit historikisht si kryeqendër e rajonit juglindor apo Anamoravës së Kosovës, tanimë është kthyer edhe në kryeqendër të rajonit ndërkufitar në trekëndëshin e komunave kufitare në mes Kosovës, Maqedonisë dhe Serbisë. Andaj, përveç vazhimit dhe intensifikimit të bashkëpunimit ndërkomunal me të gjitha komunat e rajonit tonë ndërkufitar, Gjilani do të vazhdojë edhe bashkëpunimin e mirë me organizata ndërkombëtare të qeverisjes lokale siç është Committee of Regions, ICMA (International City Management Association), Cities of Peace, etj.

Përveç shtrirjes rajonale në aspektin e bashkëpunimit edhe përbrenda, Gjilani do të ndërmarrë disa hapa konkret në realizimin e një sër projektesh kapitale e me vlerë strategjike për komunën në veçanti dhe Kosovën në përgjithësi. Në këtë kontekst dhe bazuar në diskutimet gjatë punëtorisë, disa nga këto projekte kapitale me vlerë strategjike, janë:

- *Rivitalizimi i Liqenit të Livoqit*
- *"Model Village" apo Fshati Model*
- *Radio Gjilani / Soliteri*
- *Inkubatori i Biznesit – TechnologyHUB*
- *Zona e Lirë Ekonomike – Zonë e Lirë e Mikroregjionit Evropian*
- *Shkolla e Agrobiznesit – Instituti Rajonal për Trajnime Profesionale*
- *Varrezat e Qytetit – Zgjidhja e Përhershme*
- *Hapësirat e Caktuara Publike – Zbukurim i Qytetit dhe Promovim i Brendeve Lokale*
- *Ngrohtorja e Qytetit*
- *Impianti i ujërave të zeza*
-

Siç u theksua edhe me lartë, projektet apo programet kapitale me vlerë strategjike do të ishin shtylla kryesore e krijimit të identitetit qeverisës së Gjilanit. Me fjalë tjera, këto programe i japin Gjilanit vulën e mirëqeverisjes lokale në Kosovë si shembull i një komune të zhvilluar, që përmes qeverisjes efektive dhe të bazuar në programin elektoral sjellë tek qytetarët identitet të veçantë si komunë inovative e përparimtare.

### RIVITALIZIMI I LIQENIT TË LIVOQIT

Liqeni i Livoqit gjendet në hyrje të Gjilanit nga Prishtina, d.m.th në pjesën veriperëndimore të qytetit. Historikisht, qëllimi i tij i ka shërbyer mirëmbajtjes së sistemit ujitës të tokave në Livoq dhe rrethinë. Përveç peshkatarisë lokale e individuale, Liqeni i Livoqit nuk shërben tani për tani për ndonjë aktivitet domethënës turistik apo rekreativ. Përkundër kësaj, potenciali që liqeni ofron është mjaftë i madh.

**Propozimi i diskutuar:** Për shfrytëzuar potencialin ekonomik dhe rekreativ që ofron Liqeni i Livoqit është vlerësuar se ai duhet të jepet në shfrytëzim për qëllime ekonomike-rekreative përmes Partneritetit Publiko-Privat (PPP). Qëllimi thelbësor është që hapësira rreth liqenit dhe vet liqeni të kthehen në një vend atraktive jo vetëm për peshkim dhe sporte bazike ujore, por edhe në një ambient të specializuar kulinar që do të ofronte mundësi relaksi për shumë kë.

**Plani i Veprimt:** Drejtorja për Zhvillim Ekonomik së bashku me Zyrën e Kryetarit fillimisht do të përgatisin një Koncept Dokument që hedh në pah planin ideor për këtë projekt. Mandej, në koordinim me Drejtorinë e Urbanizmit, atë të Kadastrit si dhe atë të Shërbimeve Publike, do të procedohet me hartimin e Termeve të Referencës (ToR) për të bërë studimin e fizibilitetit. Pas studimit të fizibilitetit, atëherë Komuna do t'i ndjekë procedurat ligjore në koordinim me Qeverinë e Kosovës, respektivisht Ministrinë për Tregëti e Industri (si dhe Ministri tjera të linjës sipas nevojës), për të kompletuar dokumentacionin e nevojshëm për të shpallë procedurën për PPP.

**Fusha e Impaktit:** Zhvillimi ekonomik (vende të reja pune); Turizmi.

**Afati Preliminar:** Koncept Dokumenti të përgatitet deri në fund të vitit 2018, ashtu që ToR të finalizohet deri në fund të Janarit 2019. Procedurat tjera sipas afateve ligjore.

## "MODEL VILLAGE" APO FSHATI MODEL

Një nga atraksionet kryesore nëpër vendet e zhvilluara që sjellin benefite të shumta për komunitetin, por edhe shtetin, janë fshatrat model apo "Model Villages." Tek ky lloj programi ka dy kategori kryesore përmes së cilave mund të zhvillohet fshati model: *eko-turizmi* dhe "*cultural heritage preservation*" apo *ruajtja e trashëgimisë kulturore*. Të dyja kategoritë bazohen në turizëm si degë kryesore ekonomike e zhvillimit të tyre.

Eko-turizmi ndërlidhet me ofrimin e shërbimeve dhe produkteve të pa trajtuara kimikisht apo industrialisht. Bio-fermat, bio-restorantet, dhe bio-plantacionet ku njerëzit mund të vet shërbehen (me kosto, kuptohet), janë elementet kyçe që përcaktojnë një fshat model të kategorisë së eko-turizmit.

Ndërsa, tek kategoria e dytë, ruajtja e trashëgimisë kulturore, fshati model ruhet apo restaurohet në një gjendje të prezervuar nga një kohë më e lashtë dhe shërben si një lloj muzeu i hapur që shpërfaqë vlerat e jetesës në të kaluarën. Prezervimi i një vendbanimi për t'a kthyer të njëjtin në një fshat model, kërkon punë intensive dhe partneritet me pronarët e tokave, shtëpive dhe stallave të ndryshme të vendbanimit në fjalë, si dhe të institucioneve apo ekspertëve të fushës së trashëgimisë kulturore. Në këtë lloj fshati, ruhet dhe tregohet e pasqyrohet kultura e së kaluarës në çdo sferë të jetës—familja, bagëtia, bujqësia, shkollimi, tradita, doket, zakonet etj.

**Propozimi i diskutuar:** Fshati Bukovik gjendet rreth 8km në juglindje nga qendra e Gjilanit. Rruga që e lidhë qytetin me Bukovikun (përmes Malishevës) edhe pse e ngushtë, është e asfaltuar. Përkundër pozitës së lakmueshme gjeografike, bukurive natyrore, kullosave të bollshme, tokës së pëlleshme dhe burimeve të ujit, fshati tanimë thuhet se është komplet i boshatisur. Ky trend i boshatisjes, sidoqoftë, nuk i ka penguar disa qytetarë të Gjilanit me

prejardhje nga Bukoviku apo edhe të tjerë që në atë fshat të fillojnë dhe suksesshëm të ushtrojnë veprimtari të agrobiznesit—ferma lopësh, mjedra etj.

Andaj, si lokacion në afërsi të qytetit, dhe për shkak të pozitës që i jep Bukovikut epitelin e një prej fshatrave më piktoreskë në vend, ky fshat mund të jetë vendi ideal për projektin e “Fshatit Model” në cilën do kategori – qoftë në atë të ekoturizmit apo në atë të ruajtjes së trashëgimisë kulturore.

**Plani i Veprimit:** Të përcaktohet në vijim!

**Fusha e Impaktit:** Zhvillimi ekonomik (vende të reja pune); Turizmi; Zhvillimi Rural; Trashëgimia Kulturore.

**Afati Preliminar:** Të përcaktohet në vijim!

## RADIO GJILANI / SOLITERI

Për një periudhë të gjatë kohore, ndërtesa 13-katëshe në qendër të Gjilanit, e njohur si “Soliteri” ka qenë një ndër pikat kryesore identifikuese të qytetit të Gjilanit. Realisht, Soliteri figuron edhe në logon zyrtare të Komunës së Gjilanit dhe si i tillë mbetet një lloj ikone e qytetit. Ajo që e bënë edhe më të veçantë Soliterin është fakti së në katin më të sipërm të tij tash e disa dekada e realizon veprimtarinë e vet gazetareske radiofonike edhe radio e parë e Gjilanit, Radio Gjilani.

Hapësira e katit më të epërm të Soliterit ku edhe sot punon Radio Gjilani, me gjithë kushtet e mjerueshme, është pronë komunale. Kjo hapësirë është vend ideal për t’u shfrytëzuar në të mire të Gjilanit në përgjithësi dhe banorëve të atyshëm në veçanti.

**Propozimi i diskutuar:** Hapësira e katit më të epërm të Soliterit të rivitalizohet dhe të kthehet në një “Rooftop Restaurant” apo restaurant të pullazit përmes Partneritetit Publiko-Privat. Nga totali i hapësirës prej rreth 400m<sup>2</sup>, një pjesë e vogël (jo më shumë se 30m<sup>2</sup>) do t’i lihej

në shfrytëzim Radio Gjilanit, kurse pjesa tjetër do të vihej në funksion të një Rooftop Restorant. Apo, variant tjetër është që Komuna të ofrojë një lokacion tjetër për Radio Gjilanin (p.sh. një nga lokalet në pronësi të Komunës që jepen me ankand), ashtu që komplet hapësira e katit të epërm të Soliterit të vihej në shërbim të Rooftop-it. Rooftop Restarurant do të ishte i pari i këtij lloji në rajonin e Gjilanit. Pamjet (360-shkallëshe) që do të ofroheshin nga ai vend janë magjepse për frekuentuesit e tij.

Si parapërgatitje për të çuar këtë propozim përpara, Komuna në bashkëpunim me Radio Gjilanin dhe Këshillin e Banorëve të Soliterit, gjatë këtij viti, do të ndërmarrë përsipër restaurimin e përgjithshëm e të dy ashensorëve të ndërtesës. Njëri nga ashensorët do të jetë në funksion të të gjithë banorëve por jo edhe katit të epërm, kurse tjetri do t'i shërbej direkt katit të epërm të Soliterit, ashtu që pas hapjes së Rooftop Restorant, vizitorët e tij do të kenë çasje direkte në restorant pa bezdisur fare banorët.

**Plani i Veprimit:** Drejtoria për Zhvillim Ekonomik së bashku me Zyrën e Kryetarit fillimisht do të përgatisin një Koncept Dokument që hedh në pah planin ideor për këtë projekt. Mandej, në koordinim me Drejtorinë e Urbanizmit, atë të Kadastrit si dhe atë të Shërbimeve Publike, do të procedohet me hartimin e Termeve të Referencës (ToR) për të bërë studimin e fizibilitetit. Pas studimit të fizibilitetit, atëherë Komuna do t'i ndjekë procedurat ligjore në koordinim me Qeverinë e Kosovës, respektivisht Ministrinë për Tregti e Industri (si dhe Ministri tjera të linjës sipas nevojës), për të kompletuar dokumentacionin e nevojshëm për të shpallë procedurën për PPP.

**Fusha e Impaktit:** Zhvillimi ekonomik (vende të reja pune).

**Afati Preliminar:** Marrëveshja me Radio Gjilanin të përgatitet dhe nënshkruhet deri në fund të vitit 2018; Çështja e ashensorëve të publikohet si objektiv deri në përvjetorin e 45-të Radio Gjilanit në Nëntor 2018; Afatet tjera të përcaktohen në vijim!

## INKUBATORI I BIZNESIT – “TECHNOGLOGY HUB”

Ka gati një dekadë që Komuna e Gjilanit e ka themeluar dhe e mirëmban Inkubatorin e Biznesit. Përkundër qëllimit esencial që inkubatori e ka si një pikënisje për bizneset e reja, me kalimin e kohës, ky institucion është bërë më shumë si fole e OJQ-ve të ndryshme dhe bizneseve jofitimprurëse. Realisht, tanimë thuhet Inkubatori i Biznesit edhe e ka humbur qëllimin për të cilën është themeluar.

Andaj, është koha që ai të ri formatizohet si institucion lokal dhe të kthehet në një vend që realisht jep mundësi optimale për bizneset e reja, ato që janë në themelimin e sipër (start-up) të ndjejnë përkrahjen e Komunës në realizimin e qëllimeve të tyre afariste. Inkubatori duhet të lirohet nga barra e ofrimit të hapësirës për zyre për OJQ e organizata tjera jofitimprurëse sado madhore qofshin orientimet e tyre socio-kulturore.

**Propozimi i diskutuar:** Gjilani në vazhdimësi, por veçanërisht kohëve të fundit, ka dalë në pah si komuna e parë në Kosovë për nga numri i talenteve të rijs, sidomos në fusha ekzakte siç është matematika por edhe kimia. Nxënësit e studentët tanë po korrin suksese të vazhdueshme në rajon, Evropë e botë. Mandej, me themelimin e Universitetit Publik të Gjilanit “Kadri Zeka” dhe Fakultetit të Inxhinierisë Kompjuterike brenda tij, si dhe me faktin që Komuna e Gjilanit është e para në Kosovë që ka dalë me platformën digjitale “Gjilani Smart City” si dhe me përdorimin e sistemit elektronik të shërbimeve të gjendjes civile, Gjilani ka mundësi optimale për t’u bërë qyteti më elitari në Kosovë në aspektin e teknologjisë informative.

Andaj, është e arsyeshme që të punohet që Inkubatori ekzistues i Biznesit të kthehet në një TechnologyHUB (Fole Teknologjike) ku do të sistemoheshin “start-up” biznese me fokus të veçantë në teknologjinë informative të inxhinierinë softuerike. Përkrahës në këtë drejtim por edhe model i mirë do të ishte Calgary Global Business Center nga Alberta, Canada. Ideja themeltare është që ky TechnologyHUB në Gjilan të merrte përmasa rajonale – d.m.th të shërbente si inkubator për biznese me bazë në Gjilan, por që si ide apo si pronarë/ideatorë të kenë edhe “solopreneurs” apo afaristë edhe nga rajoni.

Mënyra më e mirë dhe më e shpejtë e realizimit të këtij projekti do të ishte përmes fondeve nga MTI të premtuara për Zonën e Lirë Ekonomike.

**Plani i Veprimit:** Drejtoria për Zhvillim Ekonomik së bashku me Zyrën e Kryetarit fillimisht do të përgatisin një Koncept Dokument që hedh në pah planin ideor për këtë projekt. Mandej, Koncept Dokumentin bashkë me një kërkesë zyrtare do ta përcjellin në MTI duke kërkuar që një pjesë e fondit të MTI-së të ndarë për Zonën e Lirë Ekonomike të Gjilanit (rreth 5 milionë Euro), nëse jo krejt, të ndaheshin për projektin e TechnologyHUB në Gjilan.

**Fusha e Impaktit:** Zhvillimi ekonomik (vende te reja pune).

**Afati Preliminar:** Koncept Dokumenti të përgatitet deri në fund të Janarit 2019.

## ZONA E LIRË EKONOMIKE - ZONË E LIRË E MIKROREGJIONIT EVROPIAN

Krijimi i Zonave të Lira Ekonomike nëpër Kosovë tanimë thuhet se është bërë një lloj klisheje e pa arsyeshme. Parku Industrial në Drenas, por edhe dy Zonat e Lira Ekonomike të krijuara së fundi si ajo në Gjakovë e Mitrovicë, kanë dëshmuar se funksionalizimi i tyre është thuhet se i pabeneft për komunat përkatëse por edhe për komunitetin e biznesit në përgjithësi. Kosova ka territor të vogël por edhe ekonomi të vogël për të pas nevojë dhe benefite të prekshme nga Zonat e Lira Ekonomike.

**Propozimi i diskutuar:** Pasi që ekziston arsyeshmëri e plotë që flet për mos justifikim të investimeve në Zonat e Lira Ekonomike ekzistuese, është mirë që të diskutohet intensivisht me MTI që pos përkrahjes për TechnologyHUB nga fondi i ndarë për Zonën e Lirë Ekonomike të Gjilanit, të përkrahët edhe ideja e krijimit të një Zone të Lirë Ekonomike për Mikroregjionin Evropian me bartë të projekti në Komunën e Gjilanit.

Ashtu siç është thënë edhe më lartë, Komuna e Gjilanit tanimë ka marrë seriozisht primatin e udhëheqësit në parim të këtij mikroregjioni që krijohet nga komunat ndërkufitare të trekëndëshit Kosovë-Maqedoni-Serbi, nga Kaçaniku e deri në Kriva Pallaknë. Prandaj një

iniciative serioze për këtë lloj projekti do të ishte shumë e mirëseardhur jo vetëm për komunitetin në fjalë, por edhe për institucionet ndërkombëtare e veçanërisht ato të BE-së që e shohin bashkëpunimin ndërkufitar në nivel lokal si mënyrën më efektive të tejkalimit të shumë sfidave e barrierave politike që përcjellin rajonin tonë në vazhdimësi.

**Plani i Veprimit:** Drejtoria për Zhvillim Ekonomik së bashku me Zyrën e Kryetarit fillimisht do të përgatisin një Koncept Dokument që hedh në pah planin ideor për këtë projekt. Mandej, Koncept Dokumentin bashkë me një kërkesë zyrtare do ta përcjellin në MTI duke kërkuar që një pjesë e fondit të MTI-së të ndarë për Zonën e Lirë Ekonomike të Gjilanit (rreth 5 milionë Euro), pos për projektin e TechnologyHUB në Gjilan, të ndaheshin edhe për Zonën e Lirë Ekonomike për Mikroregjionin Evropian me bartës Gjilanin.

**Fusha e Impaktit:** Zhvillimi ekonomik (vende të reja pune).

**Afati Preliminar:** Koncept Dokumenti të përgatitet deri në fund të shkurtit 2019.

## SHKOLLA E MESME E AGROBIZNESIT – INSTITUTI RAJONAL PËR TRAJNIME

Edhe pse një shumë e konsiderueshme e fondeve nga Danimarka janë investuar në ndërtimin e Shkollës së Mesme Profesionale të Agrobiznesit në Gjilan, duke përfshirë këtu të gjitha laboratorët perkatëse, si dhe serrat, stallat etj., numri i nxënësve të regjistruar në atë institucion bie çdo vit. Një nga arsyet më të cituara për këtë rënie të numrit të nxënësve aty ndërlidhet me faktin se shkolla në fjalë gjendet në zonën periferike të qytetit dhe në largësi të konsiderueshme nga Kampusi i Shkollave të Mesme ku realisht janë bërë bashkë të gjitha shkollat tjera të mesme të Komunës së Gjilanit.

**Propozimi i diskutuar:** Duke pas parasysh infrastrukturën dhe kushtet për punë praktike që ofron shkolla, ajo duhet të kthehet në një institut rajonal për trajnime profesionale në fushën e agrobiznesit. Sipas Rrezes e Fisit, një grant në vlerë prej 400,000 EUR nga BE është fituar tanimë për ta realizuar këtë projekt.

**Plani i Veprimit:** Të përcaktohet në vijim!

**Fusha e Impaktit:** Arsimi Profesional; Agrobiznesi.

**Afati Preliminar:** Të përcaktohet në vijim!

## VARREZAT E QYTETIT – ZGJIDHJA E PËRHERSHME

Varrezat e secilit qytet bartin mbi supë të kaluarën dhe dhembshurinë e një komuniteti për të parët. Varrezat simbolizojnë përkujdesin për të shkuarën dhe si të tilla, veçanërisht në kulturën e traditën tonë janë idilike.

Edhe pse së fundi, me insistim të Komunës dhe përkrahje të Qeverisë, Komuna e Gjilanit ka siguruar një hapësirë të re dhejtëra hektarësh ku do të vendosen varrezat e reja të qytetit, sidoqoftë, mbetet preokupues fakti se edhe pas tri-katër dekadave të rradhes, Komuna do të ketë nevojë për hapësirë të re për varreza dhe realisht në atë kohë, një gjë e tillë do të jetë e pamundur të bëhet pasi që toka publike/komunale do të ishte jo e disponueshme atëherë.

**Propozimi i diskutuar:** Duke iu referuar problematikës së mungesës së hapësirës publike në të ardhmen e afërte, për t'iu shmangur ballafaqimit me këtë problem përsëri, është trajtuar mundësia e dhënies së varrezave të reja të qytetit në menaxhim privat përmes PPP-së. Modalitetet e këtij projekti PPP për varrezat duhet të diskutohet mire dhe thellësisht edhe me komunitetet fetare para se projekti të procedohet tutje.

**Plani i Veprimit:** Të përcaktohet në vijim!

**Fusha e Impaktit:** Socio-Kulturore; Religjioze.

**Afati Preliminar:** Të përcaktohet në vijim!

Ka kohë që Komuna e Gjilanit merr kërkesa të panumërta për lejim të shfrytëzimit të disa hapësirave të caktuara publike rreth të cilave ka frekuentim të shumtë të kalimtarëve apo dendësi trafiku. Shumica e këtyre kërkesave vijnë nga biznese vendore që ofrojnë mirëmbajtjen e hapësirës në fjalë si kompensim për shfrytëzimin e së njëjtës si hapësirë reklamuese për biznesin përkatës.

Pasi që ligji në fuqi lejon vetëm dhënien në shfrytëzimin hapësirave publike përmes ankandit publik, Komuna e ka pas të pamundshme që këto hapësira t’ua jep kërkuarëve të tyre. Përkundër kësaj, me aprovimin e ligjit të ri për pronën publike që pritet të ndodhë së shpejti në Parlamentin e Kosovës, Komuna do të fitojë të drejtën e menaxhimit të plotë të pronës së vet publike. Atëherë, Komuna do të mund që një pjesë të këtyre hapësirave publike ta kthejë në burim financiar apo benefit tjetër jo material për qytetarët e vet.

**Propozimi i diskutuar:** Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri, Komuna të japë në shfrytëzim hapësirat e caktuara publike si psh. Hapësirat tek rrethrotullimet nëpër qytet, për biznese vendore të interesuara të promovojnë dinjitetshëm shërbimet apo produktet e tyre. Si kompensim, këto kompani që marrin në shfrytëzim këto hapësira, do të marrin përsipër edhe mirëmbajtjen e tyre sipas specifikacioneve dhe kërkesave të Komunës. Po ashtu, edhe reklamat e tyre do të bëhen vetëm në përputhje me kërkesat, specifikacionet dhe kriteret e cilësisë të paraqitura nga Komuna.

**Plani i Veprimit:** Të përcaktohet në vijim!

**Fusha e Impaktit:** Zhvillimi ekonomik; Ambienti.

**Afati Preliminar:** Të përcaktohet në vijim!

# PLANI STRATEGJIK I PUNËS PËR VITIN 2019

## OBJEKTIVAT KRYESORE TË PUNËS PËR 2019

Në kuadër të këtij dokumenti strategjik të qeverisjes së Gjilanit, këtu po paraqesim edhe objektivat kryesore të Drejtorive Komunale.

Secila Drejtori është përgjegjëse që në harmoni me objektivat strategjike të qeverisjes së Gjilanit të përcaktojë planin e vet të punës dhe ta implementojë të njëjtin, gjithherë duke qenë në shërbim të qytetarëve.

### DREJTORIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE

Zbatimi i një qeverisje administrative duke u bazuar në rend të parë në legjislacionin në fuqi, lehtësimeve të procedurave administrative, komunikim korrekt me qytetarët qoftë në mënyrë të drejtpërdrejt qoftë sipas formave të sistemit elektronik, afirmimi i punës së hapur në administratë, trajtimit me kohë të kërkesave të qytetarëve, profesionalizmi, paraqesin shtylla bazike përmes së cilave qytetarët absorbojnë shërbime cilësore administrative në Komunë.

Një administratë funksionale dhe transparente është gjithashtu një kontribuues i rëndësishëm për legjitimitet të shtetit dhe besueshmërisë.

Andaj, për të promovuar performancë më të avancuar të shërbimeve cilësore për qytetarët e Komunës së Gjilanit, Drejtorja e Administratës së Përgjithshme, prezanton planin dhe objektivat për periudhën : 01.01.2019 – 31.12.2019:

#### **Projekti/ detyra planifikuese më kryesore**

1. Ngritja e nivelit të përgjegjësisë dhe disiplinës në punë, shtimin e efikasitetit në shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave/parashtresave të parashtruara nga ana e qytetarëve/bizneset si dhe subjektet e tjera.

Përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, ngritja e bashkëpunimit me të gjitha drejtoritë e administratës komunale, organet e komunës dhe njësitë e tjera për shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave/lëndëve brenda afateve ligjore.

2. Fillimi i përgatitjeve për ndërtimin të dy zyrave të gjendjes civile në qytet, të cilat njëra mund të jetë në lagjen "Dardania" dhe tjetra në lagjen "Arbëria" me qëllimin më të

mirë që të bëhet dekoncentrimi i shërbimeve administrative, që ato të jenë sa më afër qytetarëve ku ata jetojnë dhe veprojnë.

3. Rregullimi i infrastrukturës së brendshme i objektit të Drejtorisë për Administratën e Përgjithshme për të evituar disa pengesa teknike që po vështirësojnë kryerjen e shërbimeve.

Rregullimi i sallës së kurorëzimeve sipas standardeve. Po ashtu, sipas nevojave, rregullimi i infrastrukturës së zyrave të gjendjes civile në fshatra.

4. Në bashkëpunim me Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, do të punojmë në krijimin dhe lansimin e Qendrës së Shërbimit të Shpejt apo ndryshe quhet ONE STOP SHOP. Përmes kësaj forme , qytetarëve to t’ju krijohen lehtësira procedurale për pajisje me kushte ndërtimore dhe leje ndërtimi, e cila është një qasje e re ndaj cilësisë së shërbimit, i cili sistem eviton burokracinë dhe vonesave gjatë kryerjes së shërbimeve.

5. Rigjenerimi i librave të gjendjes civile të cilat janë të dëmtuara. Librat e gjendjes civile, gjatë përdorimit të tyre të përditshëm janë vjetërsuar, andaj duhet bërë rregullimin e tyre për të siguruar objektivitet, efikasitet dhe transparencë gjatë kryerjes së shërbimeve administrative në relacion me qytetarët.

6. Digjitalizimi i arkivit të Komunës. Do të punohet në digjitalizimin e arkivit të Komunës e cila rezulton në qasjen e shpejt dhe transparente gjatë kryerjes së shërbimeve arkivore.

7. Organizmi i punëve të arkivit komunal përmes një protokolli hyrës, si dhe shpërndarja e lëndëve nëpër organet e komunës, drejtoritë e administratës si dhe njësitë e tjera përmes arkivimit elektronik.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në kuadër të përgjegjësisë dhe kompetencave të përcaktuara me LVL, Statutin e Komunës, Ligjin për Shëndetësi si dhe Akte të tjera nënligjore, për vitin 2019 parasheh të zhvillojë aktivitete të cilat do të realizohen përmes angazhimit të kapaciteteve ekzistuese në kuadër të zyreve të funksionojë në kuadër të DSHMS<sup>-së</sup> si dhe në bashkëpunim dhe koordinim me QKMF-në Dr. Nagip Rexhepi dhe QPS<sup>-në</sup>.

Disa nga Projektet të cilat do t'i kemi në Plan të Punës edhe për vitin 2019 janë:

### ***Trajtimi i Objektivit të QKMF-së***

Do të përkujdesemi që pas realizimit të aneks-marrëveshjes me Ministrinë e Shëndetësisë të monitorojmë realizimin e punimeve sipas planit dinamik në ndërtimin e objektivit të QKMF-së.

Kjo do të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me menaxherin e kontratës, mbikëqyrësin e punimeve të caktuara nga Komuna, mbikëqyrësin e punimeve të caktuara nga Ministria e Shëndetësisë si dhe faktorë të tjerë relevant për përfundimin e këtij Projekti.

### ***Monitorimi i punimeve në ndërtimin e Fshatit Social***

Ky është Projekt i cili ka filluar të ndërtohet më: 10. 07.2018, dhe ne planifikojmë që edhe në vitin 2019 të monitorojmë zhvillimin e punimeve në realizimin e këtij Projekti në bashkëpunim të ngushtë me donatorin, menaxherin e kontratës dhe punëkryesin.

### ***Subvencionet***

Krahas subvencioneve në Shëndetësi dhe pagesës së qirasë për një numër të caktuar të rasteve sociale edhe për vitin 2019 planifikojmë subvencionimin e Projekteve të OJQ<sup>-ve</sup> të cilat trajtojnë personat me aftësi të kufizuar.

Subvencionimi i Projekteve të OJQ<sup>-ve</sup>, bazuar në rregulloren 04/2017 do të realizohet përmes Thirrjes Publike, me të cilën mundësohet që të kemi një monitorim në realizimin e Projektit dhe njëkohësisht mbylljen e subvencioneve.

### ***DDD- Dezinsektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi***

Është Projekt të cilin Komuna përmes DSHMS<sup>-së</sup> e realizon në baza vjetore.

Edhe për vitin 2019 planifikojmë të zhvillojmë këtë aktivitet përmes operatorit ekonomik "FAUNA" me të cilin kemi kontratë kornizë.

Në kuadër të investimeve kapitale planifiojmë inicimin e procedurave të Prokurimit për ndërtimin e objektit të ambulancës të Mjekësisë Familjare në fshatin Llashticë, si dhe inicimin e procedurave për auto-ambulancë.

Planin më të detajuar, për vitin 2019 e gjeni të paraqitur sipas përshkrimit të zyrave të organizuara në kuadër të DSHMS<sup>-së</sup>.

### **Zyra për Shëndet Publik**

Për vitin 2019, Zyra për Shëndet Publik parasheh këto detyra:

- Monitorimi, vlerësimi dhe gjendja shëndetësore e popullatës
- Aktivitete dhe programe në fushën e promovimit shëndetësorë
- Imunizimi i popullatës
- Parandalimi i sëmundjeve infektive në komunitet
- Pasojat për shëndetin nga abuzuesit e substancave narkotike
- Sëmundjet seksualisht të transmetueshme
- Uji, ushqimi dhe shëndeti
- Dezinfektimi, deratizimi dhe dezinfektimi
- Shëndeti dhe higjiena shkollore
- Shëndeti mjedisor

Ky plan i punës së DKA 2019 është i derivuar nga Plani Zhvillimor i Drejtorisë për Arsim për periudhën 2016-2019. Në këtë plan janë të përfshira gjashtë objektiva, masat e objektivave dhe aktivitetet sipas dinamikës së Planit të veprimit një vjeçar, për të katër nivelet e arsimit sipas Sistemit arsimor në Kosovë është i strukturuar si në vijim:

- *Arsimi Parashkollor (ISCED 0, fëmijë të moshës < 6 vjeçare)*
- *Arsimi Fillor (ISCED 1, klasat 1-5, fëmijë të moshës 6-10 vjeçare)*
- *Arsimi i Mesëm i Ulët (ISCED 2, klasat 6-9, fëmijë të moshës 11-14 vjeçare)*
- *Arsimi i Mesëm i Lartë (ISCED 3, klasat 10-12, fëmijë të moshës 15-18 vjeçare)*
- *Arsimi i Lartë (ISCED 5-8)*

Plani 2019 ka për bazë, aktivitetet që do të realizohen në të gjitha Institucionet Parashkollore Publike, Shkollat Filllore të Mesme të Ulëta dhe të Mesme të Larta (Gjimnaze dhe Shkolla Profesionale) në komunën e Gjilanit .

Në Planin e Veprimit një vjeçarë janë të përfshira edhe aktivitetet që kanë të bëjnë me nivelin e arsimit parauniversitarë si dhe prioritetet e Institucioneve Arsimore, bazuar në Planet Zhvillimore të Shkollave ( PZSHH)

### **OBJEKTIVAT ZHVILLIMORE TË ARSIMIT PËR VITIN 2019**

#### **1.Menaxhimi efikas i arsimit**

Menaxhimi i arsimit si koncept është i gjërë, për DKA –në në planin vjetor të punës 2019 përfshinë elementet kryesore që ndërlidhen me fuqizimin e rolit të këshillave drejtuese të shkollave, profesionalizimi dhe depolitizimi i përzgjedhjes së personelit arsimor, rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në edukimin parashkollor si dhe përmirësimin e arsimimit të fëmijëve me nevoja të veçanta. Masat e parapara janë:

- 1.1. *Funksionimi i këshillave drejtuese të shkollave*
- 1.2. *Përzgjedhja e personelit shkollor*
- 1.3. *Rritja e numrit të fëmijëve në edukimin parashkollor*
- 1.4. *Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta*
- 1.5. *Rishikimi i planeve zhvillimore të shkollave*
- 1.6. *Monitorimi i performancës së mësimdhënësve*
- 1.7. *Monitorimi dhe vlerësimi i performancës së drejtorëve*

## 2. Krijimi i mekanizmave për ngritjen e cilësisë në arsim

Drejtoria është e përkushtuar të punojë në ndërtimin e mekanizmave të brendshëm të sigurimit të cilësisë, në nivel shkollë të cilët ndihmojnë vlerësimin e jashtëm të cilësisë që do të bëhet nga MASHT-i.

DKA, në bashkërenditje me MASHT për vitin 2019, do të angazhohet në ngritjen e cilësisë duke u bazuar në masat e:

- 2.1. *Fuqizimit të punës së aktiviteteve profesionale*
- 2.2. *Fuqizimi i ekipit vlerësues për procesin e vetëvlerësimit të shkollave*
- 2.3. *Zbatimi i pilot projektit ; SHKOLLA ME MËSIM - TËRË DITOR*
- 2.4. *Fuqizimi i shërbimeve këshilluese pedagogjike dhe psikologjike*
- 2.5. *Organizimin e trajnimeve në përputhshmëri me reformat në arsim*
- 2.6. *Përhapja e pilot projektit : TË NXËNIT ME MË SHUMË MËSIMDHËNËS*
- 2.7. *Monitorimi i zbatimit të planeve zhvillimore të shkollave*
- 2.8. *Furnizimi me shujta ditore për nxënësit e shkollave fillore, për nxënësit nga klasa e (I - V)*

## 3. Zbatimi i suksesshëm i kurrikulës së re

Kurrikula e re e bazuar në kompetenca sjell ndryshime thelbësore në procesin mësimor, pasi kërkon një shkallë të lartë të përgatitjes së mësimitdhënësve dhe një mënyrë ndryshe të organizimit të procesit mësimor.

Prandaj, zhvillimi profesional është bashkudhëtar i natyrshëm i kurrikulës së re, ndërsa pajisja e shkollave me mjetet konkretizimi, pako didaktike e në veçanti, me TIK, është parakusht i domosdoshëm që kurrikula e re të bëjë ndryshimin tek nxënësit.

Masat e parapara janë:

- 3.1.. *Trajnimi i mësimitdhënësve për zbatimin e Kurikules se re.*
- 3.2.. *Zhvillimi i praktikave monitoruese në zbatimin e kurrikulës së re*
- 3.4. *Pajisja e shkollave me pako të mjeteve didaktike*
- 3.5. *Rritja e zbatimit të teknologjisë informative dhe komunikuese*

#### **4. Krijimi i kushteve për mësim cilësor**

Me gjithë avancimet domethënëse që janë bërë në vitet e fundit, investimi në infrastrukturë shkollore është i pashmangshëm. Përveç zgjerimit të infrastrukturës shkollore në zonën urbane, duhet siguruar renovimin e hapësirave ekzistuese dhe mirëmbajtjen e tyre, furnizimi me materiale pedagogjike dhe didaktike, si dhe përmirësimin e kushteve infrastrukturore për nxënësit me aftësi të kufizuara.

Masat e parapara janë:

*4.1. Rritja e hapësirës shkollore*

*4.2. Renovimi i hapësirave ekzistuese shkollore*

*4.3. Mirëmbajtja e hapësirave shkollore*

*4.4. Krijimi i kushteve për nxënës me aftësi të kufizuara*

*4.5. Hapja paraleleve të reja parafillore në kuadër të shkollave, sipas nevojave të shkollave për komunitete*

*4.6. Krijimi i hapsirës së shkollave për kabinete dhe pajisja e tyre*

#### **5. Zhvillimi i arsimit profesional për t'iu përshtatur tregut të punës**

Arsimi profesional duhet të jetë në funksion të punësimit më të shpejtë të të rinjve, si dhe në funksion të sigurimit të fuqisë punëtore të kualifikuar. Për këtë qëllim, duhet investuar në përmirësimin e cilësisë së arsimit profesional dhe të relevancës së tij për tregun e punës, duke siguruar që, krahas mësimve teorike, nxënësit të zhvillojnë edhe punë praktike. Po ashtu, do të punohet drejt sensibilizimit të të rinjve për regjistrim në profile atraktive të arsimit profesional, si dhe do të realizohen studime me nxënës që kanë mbaruar shkollat profesionale, për të kuptuar më mirë ndikimin e shkollimit në karrierën e tyre.

Masat e parapara janë:

*5.1. Zhvillimi i arsimit profesional të përshtatshëm për tregun e punës*

*5.2. Sensibilizimi dhe informimi mbi orientimin e arsimit profesional*

*5.3. DKA, në bashkëpunim me shkollat, do të realizojë fushatë informimi përmes prezantimeve, fletëpalosjeve, debateve lidhur me profilet arsimore duke sensibilizuar nxënësit dhe prindërit për mundësitë dhe benefitet e regjistrimit në shkollat profesionale*

*5.4. Fuqizimi i bashkëpunimit profesional midis shkollave dhe ndërmarrjeve publike e private me qëllim të realizimit të praktikës profesionale.*

## 6. Administrata dhe Personeli

Për funksionimin më efikas të IEA-ve, dhe për zhvillimin e veprimtarive normale në të mirë të nxënësve, prindërve dhe palëve të interesit, DKA –ja harton dhe planifikon rregullore të cilat mundësojnë funksionimin më cilësor në sistemin arsimor :

Masat e parapara janë:

*6.1. Hartimi i rregulloreve të ndryshme*

*6.2. Përpilimi i kontratave të ndryshme*

*6.3.Përpilimi i vendimeve të ndryshme*

*6.4.Zhvillimi i procedurave juridike administrative si:*

*6.5.Procedurat disiplinore;*

*6.6.Procedurat e ankesave*

*6.7.Zhvillimi i procedurave të rekrutimit*

## DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Në bazë të detyrave dhe obligimeve të cilat dalin nga fushëveprimtaria e saj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa me Planin e Punës për Vitin 2019 parasheh realizimin e këtyre objektivave:

Nr.	AKTIVITETET (PËRSHKRIMI)	PERIUDHA E KRYERJES	EKZEKUTUESI
1.	Pasqyrat vjetore Financiare 2018	Janar 2019	Drejtori i Drejtorisë dhe ZF
2.	Rrjedha e Parasë (Plani CASH) për të gjitha kategoritë ekonomike	Janar 2019 dhe me rishikimin e buxhetit	Drejtori i Drejtorisë dhe ZF
3.	Formimi i dokumentacionit për Kodet e projekteve	Janar – dhjetor 2019	ZF
4.	Shpërndarja e Mjeteve të bartura nga 2018	Mars 2019	Drejtori edhe ZF
5.	Analiza dhe Alokimi i të hyrave sipas kategorive të shpenzimeve dhe nënkategorive	Për çdo muaj	Zyrtari i të hyrave dhe ZF
6.	Analiza e pagave dhe meditjeve për të gjitha programet buxhetore	Për çdo muaj	Drejtori i Drejtorisë dhe ZF
7.	Raporti Final Financiar 2018	Mars 2019	Spektori për buxhet dhe financa
8.	Formimi i dokumentacionit për participimet dhe donacionet për rritje të buxhetit dhe Alokimi i tyre.	Janar- Dhjetor	Drejtori i Drejtorisë dhe ZKF
9.	Raporti Financiar Janar mars 2019	Prill 2019	Spektori për buxhet dhe financa

10	Përgaditja e Kornizes Afatmesme buxhetore ( KAB) 2020 dhe vlerësimet e hershme 2021-2022	Qershor 2019	Sektori për buxhet dhe financa
11.	Planifikimi i Buxhetit 2020 dhe vlerësimet e hershme 2020-2021	Korrik-shtator 2019	Sektori për buxhet dhe financa
12.	Raporti Finaciar 6(gjashtë)muajor janar-qershor 2019	Korrik -2019	Sektori për buxhet dhe financa
13.	Rexhistrimi i të hyrave në Acces database dhe në SIMFK	Permanente	Zyrtarët e të Hyrave
14.	Përgaditja e Raporteve javore dhe mujore e të hyrave për të gjitha Drejtoritë	Permanente	Zyrtarët e të Hyrave
15.	Barazimi ditor me BQK-në	Çdo ditë	Zyrtarët e të Hyrave
16.	Barazimi mujor me MF-në	Çdo muaj	Zyrtarët e të Hyrave
17.	Protokolimi dhe Arkivimi i lëndëve	Çdo ditë	Arkivisti
18.	Zotimi,Çertifikimi dhe shpenzimi i mjeteve Financiare	Permanente	Sektori për buxhet dhe financa
19.	Rexhistrimi i Inventarit	Permanente	Komisionet
20.	Përgaditja dhe Shpërndarja e Faturave të Tatimit në Pronë	Janar -Mars	Sektori i Tatimit në Pronë
21.	Lëshimi i vërtetimave të ndryshme për Tatimin në pronë	Permanente	Sektori i Tatimit në Pronë
22.	Regjistrimi i objekteve të reja	Permanente	Sektori i Tatimit në Pronë

23.	Pranimi i Ankesave nga tatimpaguesit	Janar-Mars 2019	Sektori i Tatimit në Pronë
24.	Shqyrtimi i Ankesave të tatimpaguesve	Maj-Qershor 2019	Sektori i Tatimit në Pronë
25.	Vlerësimi i Bazës tatimore në Pronën e Paluajtëshme për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullorës së Tatimit në Pronë për 2020	Mars-Gusht 2019	Komisioni për vlerësim
26.	Përgatitja e Rregullores së tatimit në pronë për 2020	Shtator 2019	Sektori i Tatimit në Pronë
27.	Raporti nëntë (9) mujor	Tetor -2019	Sektori për Buxhet dhe Financa

SEKTORI I PLANIFIKIMIT

Aktivitetet e sektorit janë të listuara si më poshtë

**1 Përpilimi i detyrave projektuese për hartimin zonave të gjelbëruara dhe parqeve të përcaktuara sipas Planeve Rregulluese Urbane dhe prioriteteve komunale :**

- 1.1 Hartimi i detyrës projektuese për parkun e qytetit “ **Parku i Paqes** “ – *të shpallet konkursi*
- 1.2 Disejtimi i Bustit dhe hapësirës për vendosje në shkollën e mesme të ulët “ Zija Shemsiu”- në përfundim
- 1.3 Hartimi i detyrës projektuese për parkun e qytetit “**Baja**”–përfunduar dhe në pritje të aprovimit nga agjencioni për mbrojtjen e ujërave. *të shpallet konkursi*
- 1.4 Hartimi i detyrës projektuese për parkun “**Livadhet e Arapit**”– në proces- *të shpallet konkursi*
- 1.5 Hartimi i detyrës projektuese për objektin e **Administratës së përgjithshme** të drejtorive Komunale- në proces- *të shpallet konkursi*
- 1.6 Hartimi i Projektit Kryesor të gjelbërimit të “**Kodra e Dëshmorëve** “- i përfunduar/ shpallur në prokurim. Faza e dytë e Projektit dhe në bashkëpunim me drejtorinë e bujqësisë.
- 1.7 Përpilimi i detyrës projektuese për “**Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për nevoja të Komunës së Gjilanit**”– i përfunduar- *të shpallet konkursi*
- 1.8 Projekti i “**Palestrës së Sporteve**” në Zhegër- i përfunduar (tani në implementim duke u përcjellë punimet)
- 1.9 Shenjëzimi të “**Varrezat e qytetit sipas përkatësisë së besimit**”- modeli i përcaktuar (pritet të fillohet implementimi i tij). *të shpallet konkursi*
- 1.10 Projekti i “**Shenjëzimit të rrugëve**” në KK Gjilan- Pritet të përfundohet sipas planit dinamik në afat prej dy muajsh. Projekti i përbashkët me Agjencionin Katastral të Kosovës dhe Autoritetin Norvegjez të Hartave.- në implementim e sipër
- 1.11 Projekti i instalimit të “**Citylights dhe Billboardeve**” në rrugët e qytetit- Dizajni i përfunduar dhe pritet të shpallet në ankand publik. *të shpallet konkursi*
- 1.12 Përcjellja e punimeve dhe mbledhja e raporteve gjatë implementimit të masave të “**Efiqencës së Energjisë**” dhe përcjellja e strategjisë për Energji të Qëndrueshme.
- 1.13 Hartimi i planit të studimit të fizibilitetit për “**Instalimin e gasit natyror**” në qytet. Projekti i parë në territorin e Kosovës. Përgatitja e termave të referencës dhe shpallja për studim fizibiliteti. *të shpallet konkursi*
- 1.14 Hartimi i planit të studimit për strategjinë e “**Mbrojtjes së ajrit nga ndotja**” në territorin e qytetit dhe regjionit. Përgatitja e termave të referencës. *të shpallet konkursi*
- 1.15 Hartimi i projektit të “**Rrethrotullimit dhe Nënkalimit**” të objektet e Spitalit Regjional dhe Qendrës Kyesore të Mjekësisë Familjare në Gjilan. Rirregullimi i projektit të rrugës në bashkëpunim me DShP dhe MI- drejtorinë e rrugëve. *Ekzekutohet nga MI*
- 1.16 Planifikimi/ krijimi i qendrës për “**Shërbim në një vend**” për pajisje me dokumentacion ndërtimi. Projekti i përbashkët me drejtorinë e Administratës dhe kompanive publike në Gjilan. Pasi të bëhet elektronizimi i dokumentacionit/ hartave dhe PRRU- ve krijohet mundësia për funksionalizimin e kësaj qendre. Në bashkëpunim me DA- Gjilan

1.17 Vlerësimi i punimeve të kryera në disa objekte, prerja e punimeve apo procese përfundimtare.

*Vërejtje: Pjesa e rrugës nga qendra deri tek rrethi i ardhshëm i spitalit, do të jetë në ridizajnim dhe projektim duke marrë për bazë ruajtjen e trupit ekzistues dhe hapësirave përreth.*

## 2 Plani Zhvillimor Komunal:

2.1 Formimi i grupeve Punuese:

2.1.1 EB ( Ekipi Bazë )- i përfunduar, *në aktivitet e sipër*

2.1.2 EKP (Ekipi Komunal i Planifikimit)– i përfunduar, *në aktivitet e sipër*

2.1.3 EKK (Ekipi i Këshillues i Komunitetit)– proces, *në aktivitet e sipër*

## 3 Harta Zonale e Komunës

3.1 Formimi i grupeve Punuese:

3.1.1 EB (Ekipi Bazë)- i përfunduar, *në aktivitet e sipër*

3.1.2 EKP (Ekipi Komunal i Planifikimit)– i përfunduar, *në aktivitet e sipër*

3.1.3 EKK (Ekipi i Këshillues i Komunitetit)– proces. *në aktivitet e sipër*

3.2 Vlerësimi i dokumentit të PZhK dhe PZHU– i përfunduar si draft

3.3 Profilin dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese të Komunës së Gjilanit- në proces

4 Veprimet sipas aktiviteteve të Planit Zhvillimor Komunal

4.1 Takimi konsultativë me Drejtorët e Drejtorive lidhur me hapat, rolin, detyrat dhe përgjegjësitë gjatë procesit të hartimit të PZhK-së

4.2 Takim konsultativ me Ekipin Bazë (EB) dhe Ekipin Komunal të Planifikimit (EP) lidhur me hapat, rolin, detyrat dhe përgjegjësitë gjatë hartimit të procesit të PZhK-së

4.3 Takimet konsultative të Ekipit Bazë (EB) dhe Kompanisë INSI- Prishtinë me Drejtoritë Komunale dhe Kompanitë Publike të Komunës së Gjilanit

4.4 Shpërndarja e dokumentacionit të Raportit Sektorial të bazuar në Udhëzimin Administrativ për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Komunës nëpër Drejtoritë Komunale dhe Kompanive Publike të Komunës së Gjilanit

4.5 Përmbledhja e Raporteve Sektoriale nga Drejtoritë Komunale dhe Kompanive Publike si dhe shqyrtimi e analizimi i tyre nga Ekipi Bazë (EB)

4.6 Mbajtja e takimit me Ekipin Bazë (EB) dhe Ekipin Komunal të Planifikimit (EKP) lidhur me të arriturat, sfidat e paraqitura dhe paqartësitë lidhur me dokumentin e pranuar **"Raporti dhe strategjia sektoriale" për Drejtoritë dhe Kompanitë e Juaja.**

4.7 Takim i përbashkët me Ekipin Bazë (EB), përfaqësuesin e Kompanisë konsulente INSI dhe GIZ lidhur me harmonizimin e aktiviteteve punuese bazuar në Planet e Veprimeve të dy dokumenteve gjatë procesit për hartimin e tyre Planin Zhvillimor Komunal (PZhK) dhe Harten Zonale të Komunës (HZK)

5 Veprimet sipas aktiviteteve të Hartës Zonale të Komunës të përkrahur nga GIZ-i

## 5.1 Profili dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese

5.1.1 Mbledhja e të dhënave zyrtare për Komunën e Gjilanit si dhe sistemimi në Data Bazë (Sistemi GIS)– në përfundim të procesit

5.1.2 Vlerësimi i dokumentit të PZhK dhe PZhU nga Programi gjerman për bashkëpunim GIZ & kompania **Plan-A consulting** i përfunduar si draft dokument

5.1.3 Mbajtja e Seminarit lidhur me hapat dhe procedurat e hartimit të PZhK dhe PZHU– (29-30-31)-05-2018

5.1.4 Takime konsultative lidhur me procesin e Hartës zonale si dhe harmonizimin e hapave dhe detyrave me procesin e Planit Zhvillimor Komunal

## 6 Mbikëqyrjet, Menaxhimet, Komisionet dhe Pranimet Teknike

6.1 Mbikëqyrje e punëve sipas projekteve kapitale në kuadër të komunës

6.2 Menaxhimi i punëve sipas projekteve kapitale në kuadër të komunës

6.3 Mbikëqyrje e procesit të Planeve Rregulluese të Hollësishme

6.4 Komisionit Ad hoc për zhvillimin e procedurave të emërimit me afat të caktuar– marrëveshje për shërbime të veçanta

DSHPIB-ja, aktivitetin e punëve dhe detyrave të sajë gjatë vitit 2018 e realizoi-përfundoi me një sukses relativisht të mirë ka ende hapësirë për t'u përmisuar.

Natyra dhe volumi i punëve të realizuara por edhe i atyre të pa realizuara do të jenë të përshkruara gjerësisht në Raportin Vjetor për Vitin 2018 të Drejtorisë, i cili raport është edhe pikënisje e Planit të Punës për Vitin 2019.

### Qëllimi:

Kujdesi ndaj zbatimit të ligjit, ofrimi i shërbimeve sa më të mira për qytetarët nga DSHPIB-ja, krijimi i një ambienti të shëndoshë, ngritja e këtyre shërbimeve në një shkallë më cilësore. Bazuar në të drejtat dhe obligimet e drejtorisë nga kompetencat e saj të cilat dalin nga Ligjet, aktet nënligjore, Statuti i Komunës si dhe akteve tjera administrative me dispozita ligjore të aplikueshme, të cilat i përkasin fushë veprimtarisë në kuadër të DSHPIB-së për vitin kalendarik 2018, kanë planifikuar dhe hartuar këtë propozim të Planit të Punës për vitin 2019.

Qëllimet të cilat do të arrihen me realizimin e këtij plani të punës janë:

- Shqyrton kërkesa nga lëmi përkatëse dhe të ngjashme;
- Ndërtimi i infrastrukturës rrugëve dhe nëntokësore në tërë territorin e Komunës;
- Në përputhje me politikat zhvillimore të Komunës, nxjerr në pah prioritet për mbarëvajtjen e punëve në këtë drejtori;
- Bashkëpunon me drejtoritë përkatëse, Policinë e Kosovës, Ministrinë e Infrastrukturës, Eco Higjienën, KRU Hidromorava dhe kompani tjera lidhur me nevojat dhe prioritetet e Komunës;
- Propozon harmonizimin e rregulloreve Komunale komform ligjeve në fuqi;
- Shqyrton mundësinë e dhënies në shfrytëzim të hapësirave publike me ankand publik s: parkingje, kioskat, reklama, lokalet;
- Harton paramasat dhe mbikëqyrë projektet që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen dimërore dhe verore të rrugëve, sinjalizimin horizontal dhe vertikal; ndriçimin publik në fshatra dhe qytet, mirëmbajtja e rrugëve të rendit të tretë, larja e rrugëve dhe mirëmbajtja e parqeve, shesheve, varrezave dhe hapësirave tjera publike, shërbimin e varrimeve, transportin urbane periferik dhe bartjen publike me taksit (4+1 ulëse), bartjen e automjeteve me merimangë të tërhequra nga PK, si dhe projektet tjera që lidhen me drejtorinë;
- Menaxhon me lokalet dhe banesat e dhëna me qira

### Plani i Punës për Vitin 2019:

DSHPIB-ja në kuadër të Përgjegjësisë kompetencave dhe punëve të drejtorisë për vitin 2019, ka planifikuar që krahas përgjegjësisë dhe kompetencave të sajë të fokusohen në si vijon:

#	Aktiviteti	Periudha	Komente
1.	Zbatimin e ligjeve, statutit, vendimeve dhe urdhërave në fuqi	detyrë permanente	
2.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndërtimi i infrastrukturës rrugore dhe nëntokësore</li> <li>- Vazhdimi i mbulimit të lumit Mirusha</li> <li>Ujësjetillsi në:</li> <li>- Porodin</li> <li>- Vërbicë e Kmetocit,</li> <li>- Bilmicë,</li> <li>- Vrapçiq,</li> <li>- në rrugën Qarkore ana e djathtë.</li> <li>- Kanalizim</li> </ul> <p>Sipas kërkesës me projekte te vogla..</p>	detyrë permanente	<p>Për vitin 2019 planifikojmë kryerjen e këtyre projekteve,</p> <p><b>Asfaltimi i disa rrugëve në qytet sipas kontratës;</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Asfaltimi i rrugëve Livoç i Eperm dhe lagja Jabuqve</li> <li>- Asfaltimi i rrugëve ne Livoq te Ulet</li> <li>- Asfaltimi i rrugëve ne qytet lagja 7 shtatori</li> <li>- Ndertimi i dy urave ne Haxhaj</li> <li>- Ndertimi i urës ne fshatin Doberqan</li> <li>- Ndërtimi i terenit sportiv ne fshatin Bresalc</li> <li>- Ndërtimi i rrugëve ne lagjen Porodin (Demos)</li> <li>- Ndërtimi i trotuareve ne lagjen e Dardanise</li> <li>- Vazhdimi i asfaltimit te rr. Livoç i Poshtëm - Cernicë, (kah Konsoni</li> <li>- Vazhdimi i asfaltimit i rrugëve në fshatin Lashticë dhe fsh Velekinc,</li> <li>- Vazhdimi i asfaltimi i rrugës "Femi Agani",</li> <li>- Vazhdimi i asfaltimit rr. e Përlepnicës (zgerim),</li> <li>- Vazhdimi i asfaltimit rrugët lidhëse nga rr.Pajazit Ahmeti me rrugën e Prishtinës,</li> <li>- Vazhdimi i asfaltimit rrugës kryesore Cërnicë(zgerim)</li> <li>- Vazhdimi i asfaltimit rr. Kumanovës faza e pare, si dhe fazës 2dhe 3 (MI)</li> <li>- Vazhdimi i asfaltimit rrugët në lagj. Arbëria,</li> <li>- Rruga Hysen Terpeza,</li> </ul> <p><b>Planifikimi i realizimit të projekteve me financim nga Ministria e Infrastrukturës për asfaltim të këtyre rrugëve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rr. Enver Miftari(ka ish-OSCE)</li> <li>- Rr. Adem Jashari deri te rr. Zija Shemsiu</li> <li>- Rr. Verbice e zhegovcit Sllovi</li> <li>-Vazhdimi i zgjerimit te rrugës qendër-Livoq i Ulet</li> </ul>
3.	Pranimin, shqyrtimi i kërkesave, lëshimin e akteve të caktuara normative për lëndët pranuar	detyrë permanente	Të gjitha kërkesat bëhen përmes QSHQ, arkivimi kryesor do të bëhet në atë qendër ndërsa në drejtori do të mbetet një arkivim interno i kërkesave të qytetarëve, kurse te zyrtarët do të regjistrohen çdo lëndë që është në domenin e DSHPIB-së, duhet te rritet bashkëpunimi mes sektorëve dhe QSHQ-ja lidhur me tërheqjen e vendimeve (sidomos vendimet me pagesë) te lëshuara nga drejtoria.
4.	Ndërtimi i kapaciteteve të drejtorisë	detyrë permanente	Për një funksionim edhe më të mirë dhe për ngritje të cilësisë së shërbimeve kërkohet edhe ngritje e kapaciteteve profesionale dhe atyre teknike siç janë: Trajnime, kurse, seminare dhe këmbime përvojash; Pajisjet dhe teknologjia informative të programeve kompjuterike (arqikat, AutoCad , Sim trafik 8, programin GIZ )
5.	Ankandet Publike	Janar- dhjetor	Ne momentin e konstituivit të Kuvendit Komunal ne si drejtori do ti bëjmë kërkesë Kryetarit të komunës që të themelohet komisioni për dhënie ne shfrytëzim të përkohshëm pronave komunale dhe ato: Ankandit publik për banesat dhe lokalet të ndertuara me PPP-në, lokalet e vjetra të komunës, objektet reklamuese si dhe kiosqeve.
6.	Hartimi i rregulloreve në kuadër të DSHPIB-së	Janar-Prill Qershor –Shtator	Eshtë e nevojshme nxjerrja e akteve nënligjore që rregullojnë fushëveprimin e caktuar sa i përketë DSHPIB-së dhe harmonizimin e tyre me ligjet ne fuqi si: - Rregullorja për Shërbimet Komunale; - Rregullorja për transportin publik urbane periferik dhe transportin taksi (4+1 ulëse) të udhëtarëve
7.	Rregullimi i hapësirave publike	Janar-Qershor	Ne si Drejtori do të iniciojmë hartimin e projektit për rregullimin e hapësirës publike në Rr. Idriz Seferi, (mbrapa soliterit ) hapësirën ne lagjen ish-kamnik si dhe lokacionin të ish Higjiena.
8.	Grumbullimi i mbeturinave		Ne si organ kompetent do të kemi një bashkëpunim të përhershëm me ECO "Higjiena" për ofrimin sa ma cilësor të shërbimeve si dhe do të diskutohet për mundësin e shtrirjes së shërbimeve ne vendbanime tjera.
9.	Përgatitja dhe shpallja e ankandit publik për automjetet e konfiskuara të cilat nuk janë tërheq nga pronarët në afatin e caktuar.	Tetor-Dhjetor	Ligji për RRTRR dhe Udhëzimi Administrativ na obligon (dhe për shkak të amortizimit) që 6 muaj pas qëndrimit në autopark të automjeteve të shpallet ankandit publik për shitjen e tyre me qëllim të lirim të autoparkut si dhe obligon Komunën që të përcakton vendim ku do të qëndrojnë automjetet e tërhequra edhe në të ardhmen.
10.	Kontrolli i transportit publike të udhëtarëve me autobus dhe taksi (4+1 ulëse) si dhe mbikëqyrja e hapësirave publike	Detyrë permanente	DSHIPB-ja me anë të inspektorëve të komunikacionit dhe ins. te shërbimeve publike dhe ambientit do të bëj inspektimin permanent të bartjes publike, mbikëqyrjen e hapësirave publike dhe ndotjes së ambientit, këtu do të ketë koordinim të vazhdueshëm me Policin e Kosovës.

11.	Menaxhimi i autoparkut	detyrë perm.	Mbikëqyrja permanente e autoparkut ku kompania është e obliguar që të raportojë në baza mujore.
12.	Bashkëpunimi me Drejtorit e KK, PK, Zyren e kryetarit, Zyren Ligjore, Zyren e Prokurimit, Zyren e Auditimit, pra në përgjithësi me administratën komunale dhe me Kuvendin Komunal	detyrë permanente	Për çështje të ndryshme do të bashkëpunohet me organet adekuate, por me theks të veçantë do të angazhohemi në ngritjen e nivelit të bashkëpunimit me Drejtorin e Kadastrës, Urbanizmit, Departamentin e Prokurimit si dhe me drejtorit tjera komunal dhe PK.
13.	Angazhime në përbushjen e standardeve	detyrë permanente	DSHIPB-ja do t'i kushtojë rëndësi të posaçme dhe permanente përbushjes së standardeve për fushë-veprimtarimë e sajë (sinjalizimim e emërtimi i rrugëve, vendbanimeve, shesheve, numrave të objekteve, transportit publik të udhëtarëve, sigurisë në komunikacion, për palën - lëshimi i aktit të caktuar në gjuhën e kombeve që jetojnë në komune.
14.	Bashkëpunimi me PK	detyrë permanente	Ky bashkëpunim do të fokusohet kryesisht në sigurimë në komunikacion, si dhe në krijimin e kushteve për qarkullim të lirë të qytetarëve dhe automjeteve në trafik, lirimim e trotuareve shmangien e shenjave, përkatësisht në zbatimin e ligjeve në fuqi si dhe të Rregulloreve komunale, si dhe përgatitjen e planeve për aksione për lirimim hapësirave publike dhe trotuareve .
15.	Dhënia e lejeve për hapësira publike	Prill-Tetor	Lëshuara e lejeve sipas rregullores komunale për hapësira Publike (frigoriferë dhe para kafetërive) sipas dimezimeve të caktuara nga zyrtarët e drejtorisë
16.	Rritje e inkasimim e të hyrave	detyrë perm.	Në bashkëpunim QSHQ me inspektionim komunal, qytetarët, PK -në etj.
17.	Përgatitja e projekteve të përhershme kryesisht të mirëmbajtjeve	Janar - Tetor	Projektet: Harton paramasat dhe mbikëqyrë projektet që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen dimërorë dhe verore të rrugëve, sinjalizimim horizontal dhe vertikal, ndriçimim publik në fshatra dhe qytet, mirëmbajtja e rrugëve të rendit të trete, larja e rrugëve dhe mirëmbajtja e parqeve, shesheve, varrezave dhe hapësirave tjera publike, transportin urbano- periferik dhe transportin publike me taksii 4+1, bartja me merimangë, Mirëmbajtja e investimeve publike, shërbimi i varimit si dhe projektet tjera që lidhen me këtë sektor

18.	Mbikëqyrje permanente e projekteve të përhershme – vjetore, të mirëmbajtjeve	Gjatë kohës së implem. të projekt	Konsiderojmë se mbikëqyrja e projekteve të përhershme vjetore duhet të mbikëqyrën nga personeli i drejtorisë sepse kryesisht këto projekte janë projekte të mirëmbajtjeve dhe me realizimim e këtyre punëve dhe vërtetimim e tyre në ditatë të punës dhe libër ndërtimor njëkohësisht bëhet edhe pranimi i tyre.
19.	Rregullimim e trotuareve si dhe nivelimim me rrugë për personat me aftësi të kufizuar, si dhe caktimim i parkingjeve për taxi, për qytetarë në rrugët e qytetit si dhe para objekteve banesore caktimim i parkingjeve për personat e hendikosit si dhe për biçikleta nga fushë veprimtaria e drejtorisë (komunikacion, rrugë, etj.)	detyrë permanente	Nëpër gjithë rrugët e qytetit si dhe në fshatrat përreth qytetit
20.	Furnizimim me ujë të pijshëm	detyrë permanente	DSHIPB-ja do të jetë gjithmonë në bashkëpunim të ngushtë me Kompaninë regionale KRU "Hidromorava" që qytetarëve tu sigurohet uji të pijshëm, të bëhet plane të përbashkëta me drejtorim për zgjerimim e rritjet të ujësjellësit në vendbanime ku mungon uji i pijshëm. DSHPIB-ja do të kërkoj nga kompania nga një kopje të analizave të ujit
21.	Raportet	detyrë permanente	Secili zyrtar kompetent në fushë veprimtarim e ti është i obliguar që në baza javore ti raportoj udhëheqës im e ti. Përmas raporteteve periodike do të kontrollohet edhe realizimim i planit të punës.

## DREJTORIA E BUJQËSISË DHE PYLLTARISË

### Buxheti 2019

Planifikimi i të Hyrave	2019
Shitja e masës drusore në këmbë	20,000.00 €
Shitja e masës drusore të konfiskuar	3,000.00 €
Gjithsejtë:	23,000.00 €
Participime dhe donacione	346,600.78 €

Planifikimi i Shpenzimeve			2019		
Paga	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione	Shpenzime kapitale	Gjithsejtë:
Buxheti Komunal					
155,268.00	17,000.00	6,000.00	175,000.00	100,000.00	453,268.00
Donacione					
20,000.00	99,744.78		226,856.00		346,600.78
Gjithsejtë:					
175,268.00	116,744.78	6,000.00	401,856.00	100,000.00	799,868.78

Synimi kryesor i DBP-së është që përmes përkrahjes së fermerëve në forma të ndryshme të ndikojë në:

- - Krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë.
- - Shfrytëzimin maksimal të tokës bujqësore.
- - Rritjen e prodhimtarisë bujqësore.
- - Hapjen e vendeve të reja të punës dhe
- - Zvogëlimin e importit.

## SEKTORI I BLEGTORISË

### 1. Gjendja aktuale

Në komunën e Gjilanit operojnë disa kompani të qumështit si: KABI, ARD dhe kompani tjera të regjionit të cilat kooperojnë me bujqit tanë si: BYLMETI, RONA, ALPINA, MAGIC ICE etj. me kapacitete të mjaftueshme për grumbullimin e gjithë sasisë së qumështit të prodhuar.

Po ashtu në komunën e Gjilanit operojnë edhe dy mishtore: NATYRA ( KALABRIA ) dhe MALËSIA me kapacitete regjionale dhe këto na japin mundësi me e zhvillu sektorin për trashje të viçave pa kufishëm.

Deri diku e kemi zgjidhur furnizimin me mjelëse lëvizëse, ku deri më tani kanë përfituar mbi 400 blegtorë, që kanë kultivuar mbi 4 krerë gjedhe, bidonë të inoksit për ruajtje dhe transportim të qumështit janë shpërndarë 200 copë te fermerët që prodhojnë qumësht për industri dhe janë pajisur 10 fermerë të zonave të thella me Llaktofriza 350 dhe 400 litërsh.

Fermerët ballafaqohen me shumë sfida si: Strukturën racore, mungesën e infrastrukturës stallore, mungesa e ushqimit, mekanizimit jo të plotë bujqësorë etj.

#### *Nësektori i gjedheve*

Gradualisht është duke u zhvilluar, nga fondi total i gjedheve prej 7500 krerë, 4500 janë lopë qumështore. Në komunën e Gjilanit operojnë 396 ferma të lopëve qumështore, të cilat mbarështojnë metis të racave të ndryshme si: Hollshtajn i kuq, Hollshtajn bardh e zi, Simental etj.

Plasmani i qumështit është mirë i rregulluar dhe prodhuesit e qumështit nuk kanë probleme në këtë drejtim, një pjesë dërmuese e tyre qumështin e shesin në qumështore, ndërsa rreth 150 ferma tjera qumështin e plasojnë në tregun joformal.

Ferma për trashje të viçave janë 130, ndërsa fermerët tjerë rrisin viçat mashkuj në ferma të kombinuara prej 3 deri në 9 mujsh dhe i plasojnë në treg.

Për mbarështuesit e viçave për trashje poashtu ka një treg të mirë si në thetore të cilat kanë kapacitete të pranojnë të gjitha kafshët për trashje.

Kapacitetet prodhuese për qumësht gjedhi janë: 40 % në raport me konsumin.

Kapacitetet prodhuese për mish gjedhi janë: 15 - 20 % në raport me konsumin.

Aktivitetet:

1. Mbështetja e fermerëve për aplikim në skemen e subvencioneve për krerë, cilësi të qumështit dhe granteve të MBPZHR.
2. Pajisja e 50 fermerëve me makina mjelëse.

3. Në bashkëpunim me shkollën e mesme bujqësore të agro-biznesit ARBËRIA do të subvencionojmë fermat egzistuese me krerë të racës së pastër SIMENTAL me qëllim të përmirësimit racor.
4. Do të kërkojmë forma të mbështetjes së sektorit për rritje dhe trashje të viçave për majmëri nga donatorët dhe ndërtimi i partneriteteve strategjike të kompanive të mishit që operojnë në komunën tonë.
5. Ndërtimi i tregut të kafshëve me standarde evropiane.
6. Krijimi i kushteve në tregun e gjelbër për prodhuesit vendor për shitjen e bylmetrave.

### ***Nësektori i kafshëve të imta ( dhenëve dhe dhive )***

Komuna ka resurse të mira për mbarështimin e kafshëve të imëta: Kullosa, livadhe dhe tokë bujqësore për të plotësuar nevojat e tyre ushqyese.

Kemi 44 fermerë që mbarështojnë dhentë dhe numri total i tyre në Komunë është rreth 6000 krerë. Racat dominante janë metisët e deleve të Sharrit dhe Virtembergut. Infrastruktura stallore është e dobët dhe nuk kanë treg të organizuar për qumësht, qengja dhe për lësh.

Kapacitetet prodhuese janë 20 % në raport me konsumin.

Numri i fermave të dhive është 12 me rreth 1600 krerë. Dominojnë racat ballkanike dhe diku rreth 20 % e dhive janë të racave Alpine si ajo e Francës, Zvicrës etj.

Komuna, DBP në bashkëpunim me CARE ka ngritë një pikë grumbulluese dhe përpunuese të qumështit të dhisë në Bresalc e cila ka bërë kontratë me 20 fermerë të cilët e dërgojnë qumështin në këtë pikë, dhe pjesa tjetër e fermerëve përgatisin djathë në ekonomit e veta shtëpiake dhe e shesin në treg. Kjo pikë grumbulluese tani është zhvilluar në kompani BIOPRODUKT duke ngritur kapacitetet në 160 krerë dhe ka instaluar sistemin automatik të mjeljes.

Kapacitetet prodhuese janë mbi 20 % në raport me konsumin.

Aktivitetet:

1. Mbështetja e blegtorëve për aplikim në skemën e subvencioneve për krerë dhe granteve të MBPZHR.
2. Do të kërkojmë mundësin e furnizimit të bujqëve me dele dhe dhi të racave të pastërta, në partneritet me donator të ndryshëm dhe me fermerë.
3. Organizimi i një tregu të përbashkët me tërë infrastrukturën e duhur përcjellëse për shitjen e kafshëve.
4. Krijimi i kushteve në tregun e gjelbër për prodhuesit vendor për shitjen e bylmetrave.

## Bletaria

Komuna numëron 303 bletarë me 9899 shoqëri, prej të cilëve mbi 103 bletar kultivojnë mbi 30 shoqri dhe nga MBPZHR janë subvencionuar 5899 shoqëri bletësh. Komuna e Gjilanit ka mbështetur në vazhdimësi bletarët me 750 shtëpiza, 155 bletar janë pajisur me rroba dhe pajisje për bletar, si dhe janë pajisur me 100 centrifuga elektrike për nxjerrjen e mjaltit të gjithë bletarëve që kultivojnë mbi 30 shoqëri bletësh.

Kapacitetet mbarështuse bazuar në resurset natyrore që ka Komuna e Gjilanit janë për 15.000 shoqëri të reja gjë që lënë hapësirë si për rritje kapacitetesh ekzistuese poashtu edhe për bletarë të rinjë, gjë që do i plotësonte nevojat e konsumit lokal, por dhe mundësitë për eksport. Ky sektor është zhvilluar hovshëm 5 vitet e fundit dhe kapacitetet prodhuese janë 40 % në raport me konsumin.

Aktivitetet:

1. Mbështetja e bletarëve për aplikim në skemën e subvencioneve dhe granteve të MBPZHR.
2. Furnizimi i 100 bletarëve fillestar me nga 10 shtëpiza për bletë, gjithsejtë 1000 shtëpiza bletësh.
3. Organizimi i panairit të mjaltit.
4. Krijimi i kushteve të përshtatshme për shitjen e mjaltit.

## SEKTORI I LAVËRTARISË DHE PERIMKULTURËS

Komuna e Gjilanit posedon kushte të përshtatshme klimatiko – tokësore, që mundësojnë organizimin e prodhimtarisë së suksesëshme të kulturave lavërtare dhe perimore. Përpos kulturave bazike Grurit dhe Misrit, tani janë duke u rritur sipërfaqet në llogari të kulturave perimore si në ambient të hapur ashtu edhe në ambient të mbyllur.

- Sipërfaqet e mbjella me grurë rreth 2000 ha
- Sipërfaqja e mbjellë me elb 100 ha
- Sipërfaqja e mbjellë me tërshërë 150 ha
- Sipërfaqet e mbjella me misër 2000 ha
- Sipërfaqet e mbjella me patate 150 ha
- Sipërfaqet që mbjellen me kultura perimore në fushë të hapur 400 ha
- Sipërfaqet në ambiente të mbyllura rreth 30 ha.
- Sipërfaqet e mbjella me bimë furagjere 1000 ha.

Plotësimi sa më i madh i nevojave vetanake me komponentën ushqyese është synim i yni dhe mund të arrihet përmes rritjes së rendimentit mesatar. Paketa teknike për arritjen e kësaj përfshin:

- farën e kualitetit të lartë
- mbjelljen e mekanizuar
- mbrojtjen e bimëve
- zbatimi i masave agroteknike dhe

- plehrimi me mineralet e nevojshme.

Kosova importon sasi të konsiderueshme të miellit të grurit edhe pse ekzistojnë kushtet për prodhimin e tij në vend. Në bazë të rendimenteve të grurit të korrura gjatë vititeve të fundit komuna e Gjilanit i plotëson nevojat e popullatës me grurë mbi 50 %.

Komuna e Gjilanit ka mbështetur këtë sektor në vazhdimësi duke subvencionuar mbjelljet pranverore dhe vjeshtore në plotëni, duke furnizuar me mekanizëm bujqësor bujqit, si dhe duke i trajtuar rrugët fushore me zhavorr.

Presim funksionalizimin e kombinatit të duhanit dhe komuna do të subvencionon bujqit e interesuar për prodhimin e kulturës së duhanit dhe një mundësi e mirë është kultivimi i lulediellit për nevojat e fabrikës Floil e cila operon në komunën tonë.

Aktivitetet:

1. Subvencionimi i mbjelljeve pranverore me farë misri dhe pleh mineral.
2. Subvencionimi i mbjelljeve vjeshtore me farë gruri.
3. Mbështetja e mbi 100 fermerëve me mekanizëm përcjellës për bujqësi ( Spërkatëse, freza, piatore, kositëse rotative dhe grumbulluese të sanës ).
4. Trajtimi i më shumë se 20 km sipërfaqe rrugore ( shtrimi i rrugëve me zhavorr ).
5. Mbështetja e fermerëve për aplikim në skemën e subvencioneve dhe granteve të MBPZHR.

### ***Kultivimi i perimeve***

Kultivimi i perimeve kërkon angazhim më të madh të fuqisë punëtore, ashtu që ndikon në punësim për disa herë më tepër se sa lëmit tjera të bujqësisë. Shtimi i prodhimit të perimeve, do të ndikonte në furnizimin e tregut dhe zbutjen e deficitit tregtar të tyre. Shumica e kulturave perimore ( domatja, speci, trangulli etj.) kanë origjinë nga viset e nxehta, për këtë arsye, në fushë të hapur kultivimi i tyre është i mundur për një periudhë të shkurtër kohore. Ngritjes së serrave ju është kushtuar rëndësi në vazhdimësi si nga buxheti komunal ashtu edhe nga donator të ndryshëm dhe tani sipërfaqet e serrave mbulojnë mbi 30 ha.

Në fushë të hapur kryesisht kultivohen shalqiri, pjepri, lakra, qepa, hudhra, karota etj. perime këto që kanë vegjetacion më të shkurtër. Vlerësohet se në komunën e Gjilanit kultivohen mbi 400 ha perime në ambiente të hapura.

Në kushte tona klimatike, prodhimtaria e perimeve ka karakter sezonal. Prandaj, prodhimtaria në ambiente të mbyllura, paraqet një mundësi të mirë për ndryshimin e këtij karakteri sezonal.

Në vitet e fundit tek ne, vërehet një orientim i madh i prodhuesve për këtë mënyrë të kultivimit të perimeve. Intensifikimi i mëtejshëm i prodhimtarisë së perimeve në ambiente të mbrojtura do të eliminonte karakterin sezonal të prodhimtarisë dhe do të mundësonte

furnizimin e vazhdueshëm të tregut me perime të freskëta gjatë tërë vitit me çmime të arritshme për konsumatorin.

Për nga aspekti ekonomik, kultivimi i perimeve në serra paraqet mënyrën më intensive me q'rast arrihen rendimente mjaft të larta dhe afate kohore të planifikuara. Plotësimi i nevojave të popullatës me perime sillet rreth 50 %.

Synimi ynë është zënia e tregjeve vendore dhe furnizimi i qytetarëve me prodhime të shëndetshme. Në vazhdimësi kemi pajisur perimtarët me serra dhe do të vazhdojmë duke kërkuar edhe donacione shtesë nga donator të ndryshëm.

Këtij nënbsektori ju ka shtuar edhe një kompani vendore e prodhimit të plehrave kristalore në Kmetoc „NUTRIVIDA“, e cila do të ketë ndikim esencial në zhvillimin e këtij nën sektori.

Aktivitetet:

1. Mbështetja e perimtarëve për aplikim në skemen e subvencioneve dhe granteve të MBPZHR.
2. Pajisja e 20 perimtarëve me serra komerciale me sipërfaqe 200 m<sup>2</sup>, serra të zinguar me foli dhe qëndrueshmëri afatgjate.
3. Pajisja e perimtarëve me foli plastike për serra.

## **SEKTORI I PEMËTARISË**

Gjilani njihet si regjion pemëtar, duke ju falënderuar kushteve klimatiko – tokësore të përshtatshme, që mundësojnë organizimin e prodhimtarisë së suksesshme pemtare. Përveç kushteve natyrore, ekziston edhe zingjiri përpunues dhe ai ruajtës mjaft i konsoliduar me fuqi të mjaftueshme punëtore, kështu që me sukses mund të kultivohen shumica e llojeve të pemëve kontinentale. Kompanitë që operojnë në komunën e Gjilanit, e që i japin fuqi zhvillimore këtij sektori janë: MOEA, ASK FOODS, AGMIA FROOTS, CALABRIA, DHEMETRA etj.

E konsiderojmë me interes për bujqësinë komunale, që edhe pemëtaria të trajtohet me prioritet të lartë zhvillimor sepse:

1. Kostoja e prodhimit për njësi të pemët, si ato farore, bërthamore dhe pemët e imëta, është për dy e më tepër herë më e vogël se sa çmimi i shitjes së produktit;
2. Shtimi i prodhimit të frutave, do të ndikonte në furnizimin e tregut dhe zbutjen e deficitit tregtar të tyre.
3. Kultivimi i pemëve kërkon angazhim më të madh të fuqisë punëtore, ashtu që ndikon në punësim për disa herë më tepër se sa lëmitë tjera të bujqësisë.
4. Industria përpunuese dhe ruajtëse është shumë e zhvilluar dhe ofron mundësi të zgjerimit të prodhimit të pakufishëm.

Gjendja e pemëve të vjetra që gjenden në zonat rurale dhe që janë në kultivim ekstensiv është jo e mirë, tani kryesisht janë në fund të jetëgjatësisë së tyre dhe në proqes të tharjes, andaj është me interes ripërtirja dhe investimi në pemëtore të reja.

Sipas shënimeve që disponojmë, në territorin e komunës së Gjilanit me pemë frutore janë të mbjella gjithsejtë rreth 300 ha kryesisht në kultivim gjysëm intensiv dhe intensiv.

Synimi ynë është ngritja e pemishteve të reja me lloje, variete dhe nënshartesa të përshtatshme për kushtet tona.

Sasia e nevojshme ditore e konsumit të frutave të pemëve frutore për një person është rreth 200 deri 250 gr, ndërsa e përlogaritur për një vit është rreth 100 kg.

Nga kjo mund të konkludohet se nevojat e tregut të Gjilanit për fruta pemësh në nivel vjetor janë mbi 1000 vagon ose (100000 banor x 100 kg =10 000 000 kg ose 1000 vagon),e që do t'i përgjigjej sipërfaqeve me pemishte prej 400 deri 500 ha,me një mesatare të rendimentit për ha prej 20 000 deri 25 000 kg ).

Nga kjo që u tha mund të konstatohet se për plotësim të nevojave të tregut të komunës së Gjilanit me pemë frutore është e nevojshme që të ngritën edhe rreth 200 deri 250 ha, ndërsa kur kihet parasysh mundësia e përpunimit si dhe eksporti i tyre atëherë nevojat për investime janë shumë ma të mëdha. Vëmendje e veçantë do ti kushtohet pemëve të imta si: Mjadrës, manaferrës dhe dredhëzës, si dhe masave për mbrojtjen e tyre.

Aktivitetet:

1. Mbështetja e pemëtarëve për aplikim në skemën e subvencioneve dhe granteve të MBPZHR.
2. Ngritja e pemishteve me pemë të imëta nga granti i USAID-it.
3. Ngritja e 20 ha me kulturën e arrës.

Aktivitetet tjera që planifikohen në drejtorin e bujqësisë dhe pylltarisë janë:

- Trajtimi i qenve pa pronar në bashkëpunim me AUVK.
- Ruajtja e pyjeve nga prerësit ilegal
- Përgatitja e ankandit për dhënien e vend gjuetive në shfrytzim
- Organizimi dhe monitorimi i fushatës së korrje- shirjeve.
- Pastrimi dhe pararrallimi i pyjeve publike
- Ripyllëzimi i sipërfaqeve të ç'veshura me pishë të bardh dhe të zezë.
- Gjelbrimi i hapsirave publike
- Përkujdesi për shëndetin e kafshëve shtëpiake dhe
- Manifestimi tradicional Darka e Lamës.

### Aktivitetet e planifikuara për vitin 2019

Klasifikimi	Përshkrimi	Vlera	Fillimi i aktivitetit	Mbarimi i aktivitetit
Mallra dhe shërbime	Material Shpenzues për zyre	1,400.00	Janar	Dhjetor
	Furnizim me kompjuter	3,500.00	Janar	Dhjetor
	Furnizim me material të shtypur dhe botuar	1,200.00	Janar	Dhjetor
	Furnizim me material riparues teknik	1,300.00	Janar	Dhjetor
	Furnizim me fotokopjues dhe shtypës	3,000.00	Janar	Dhjetor
	Participim në subvencionim të naftës për bujq	5,600.00	Janar	Dhjetor
	Darka e Lamës	1,000.00	Shtator	Tetor
	Gjithsejtë:	17,000.00		

Klasifikimi	Përshkrimi	Vlera	Fillimi i aktivitetit	Mbarimi i aktivitetit
Subvencione	Furnizim me farë misri dhe pleh mineral	20,000.00	Shkurt	Prill
	Serra komerciale	30,000.00	Shkurt	Maj
	Shtëpiza për bletë	10,000.00	Shkurt	Maj
	Makina mjelëse	10,000.00	Mars	Qershor
	Mekanizim bujqësor	35,000.00	Prill	Korrik

	Furnizim me farë gruri	45,000.00	Korrik	Tetor
	Furnizim me fidane të arrës	25,000.00	Gusht	Nëntor
	Gjithsejtë:	175,000.00		

Klasifikimi	Përshkrimi	Vlera	Fillimi i aktivitetit	Mbarimi i aktivitetit
Investime kapitale	Ndërtimi i rrugëve fushore për nevoja të bujqëve	70,000.00	Qershor	Tetor
	Gjelbrim i hapsirave publike	20,000.00	shtator	Dhjetor
	Populimi me kafshë të egra i tri vendgjuetive	10,000.00	Gusht	Dhjetor
	Gjithsejtë:	100,000.00		

## DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë , realizon të gjitha punët për ushtrimin e kompetencave të deleguara nga niveli qendror lidhur me shërbimet kadastrale, gjeodezike dhe pronësore duke u mbështetur në legjislativonin në fuqi i cili e rregullon këtë fushë.

Gjithashtu, ushtron kompetencat e veta edhe gjatë ofrimit të shërbimeve për administratën komunale për nevoja të realizimit të projekteve komunale. Ofron shërbime nga fushë veprimtaria e vet për nevoja të institucioneve tjera : Gjykatat në të gjitha nivelet, Prokurorinë e Shtetit, Policinë e Kosovës, Agjencionin Antikorrupsion etj.

### PËRBËRJA E DREJTORISË

Të gjitha kompetencat e veta dhe ofrimi i shërbimeve nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, ofrohen përmes tre sektorëve të veçantë (Sektori i Gjeodezisë, Sektori i Kadastrit dhe Sektori i Pronës ) por që kanë lidhje shumë të ngushta njëri me tjetrin. Drejtoria ka gjithsej 25 shërbyes civil si dhe udhëheqësin e tyre – Drejtorin.

### PLANIFIKIMI

Në bazë të detyrave dhe obligimeve të cilat dalin nga fushëveprimtaria e saj, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë me Planin e Punës për Vitin 2019 parasheh realizimin e këtyre objektivave :

### PLANI I PUNËS 2019

Nr.	OBJEKTIVI (PËRSHKRIMI)	PERIUDHA E KRYERJES	AKTIVITETET	EKZEKUTUESI
1.	Shqyrtimi dhe vendosja me prioritet të kërkesave të parashtruara në fund vitin 2018 që ndërlidhen me afate ligjore	Janar	-hartimi i listës së kërkesave	DGJKP
2.	Rindërtimi i të dhënave kadastrale për pronat e evidentuara në fletën posedues nr.3208 ZK Gjilan.  (Lagja Dheu i Bardh dhe Kodra e Dëshmorëve)	Janar - Dhjetor	Sipas kërkesave të palëve	Komisioni i DGJKP-së
3.	Zhvillimi i procedurave të shpronësimit të pronave private për	Janar – Dhjetor	Sipas detyrës	Kryetari i

	nevoja te realizimit te interesit publik sipas Planeve Rregulluese Urbane të miratuara në Kuvendin Komunal		zyrtare	Komunës DGJKP
4.	Identifikim të ngastrave Parcelim te ngastrave kad. Rilevim të objekteve Bashkim të ngastrave kad. Identifikim i njësive banesore Kërkesa të uzurpimeve Kërkesa të institucioneve Kopje plani Këkesa për të dhëna Grafike Kërkesa të sek. privat për azhurnim në bazën Grafike Kërkesa të sek. të pronës për azhurnim në bazën grafike Kërkesa Administrative Kërkesa informative –përgjigje	Janar – Dhjetor	Sipas kërkesave të palëve	DGJKP
5.	Regjistrimi i Vendimeve Përfundimtare në RDPP për nevoja të shpronësimit për realizimin e projekteve të nivelit qendror të cilat lidhen me Komunën e Gjilanit	Janar-Dhjetor	Sipas kërkesës së MMPH	DGJKP
6.	Parcelimi i sipërfaqeve të kompensuara nga procedura e shpronësimit në nivelin komunal	Janar- Dhjetor	Sipas detyrës zyrtare	DGJKP
7.	Trajtimi i rasteve të uzurpimit të pronave komunale	Janar - Mars	Sipas detyrës zyrtare	DGJKP
8.	Hartimi i listës me prioritet të rasteve të uzurpimit dhe ekzekutimi i të	Janar-Dhjetor	Sipas detyrës zyrtare	DGJKP

	njëjtave			
9.	Parcelimi i sipërfaqeve të kompensuara nga procedura e shpronësimit në nivelin komunal dhe nivelin qendror	Janar-Dhjetor	Sipas detyrës zyrtare MMPH	DGJKP
10.	Regjistrimi në RDPP në emër të Organit Shpronësues i parcelave të kompensuara nga procedura e shpronësimit në nivelin lokal dhe qendror	Janar-Dhjetor	Sipas detyrës zyrtare MMPH	DGJKP
11.	Komunikimi i vazhdueshëm me AKP-në dhe Qeverinë e Kosovës lidhur me pronat e N.Sh. për nevoja të realizimit të interesit publik	Janar - Dhjetor	Sipas detyrës zyrtare	Kryetari i Komunes dhe Drejtori i DGJKP-se
12.	Ofrimi i shërbimeve pronësore, kadastrale dhe gjeodezike për nevoja të projekteve komunale	Janar- Dhjetor	Sipas detyrës zyrtare dhe me kërkesa të palëve	DGJKP
13.	Ofrimi i shërbimeve për qytetarët lidhur me çështjet pronësore juridike kur kemi të bëjmë me pronat komunale	Janar- Dhjetor	Sipas detyrës zyrtare dhe me kërkesa të palëve	DGJKP
14.	Ofrimi i informatave lidhur me çështjet pronësore për nevoja të Gjykatave, Avokatin e Komunës, Prokurorinë e Shtetit, Policinë e Kosovës, Agjencionin Antikorrupsion etj.	Janar - Dhjetor	Sipas detyrës zyrtare dhe me kërkesa të palëve	DGJKP
15.	Pjesëmarrja në tryezat e ndryshme të organizuara në nivelin lokal dhe qendror lidhur me çështjet pronësore.	Janar - Dhjetor		DGJKP

## **FAKTORËT E RREZIKUT**

Për kryerjen e këtyre aktiviteteve me qëllim të arritjes së objektivave të parapara me Planin e Punës për Vitin 2019, kemi identifikuar disa vështirësi – faktorë të rrezikut të cilët mund të paraqiten si pengesë për arritjen e objektivave dhe rezultateve më të mira të parapara me Plan.

Këta faktorë janë :

1. Mungesa e dokumentacionit kadastral ,
2. Pengesat e shpeshta në sistemin e programit SIKTT /rënia e rrjetit të internetit,
3. Mungesa e adresave të sakta dhe shënimeve tjera personale të pronarëve apo zotëruesve të interesit të pronave të cilat janë objekt i shpronësimit.
4. Gabimet e planeve kadastrale gjatë skanimit dhe gjeoreferencimit nga AKK

## **FAKTORËT E SUKSESIT**

1. Disiplina dhe vijueshmëria e rregullt në punë,
2. Ngritja e mëtejme profesionale e zyrtarëve përmes trajnimeve, pjesëmarrjes në seminare dhe punëtori të ndryshme të cilat ndikojnë në punën e tyre profesionale
3. Avansimi i vazhdueshëm me teknologji informative të kohës si dhe blerja e pajisjeve gjeodezike GPS (kopos-2018)

## DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH) në punën e saj mbështetet: në ligjet, urdhëresat administrative dhe rregulloret në fuqi, si: Ligji për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera Nr. 04/L-027; Ligjin për Mbrojtje kundër Zjarrit Nr.02/L-41; Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L014; Udhëzimi Administrative Nr. 19/2008; Statusin e Kuvendit të Komunës së Gjilanit; Plani për Vlerësimin e Rrezikut në territorin e Komunës së Gjilanit: dhe Plani i Reagimit Emergjent Komunal.

DMSH, është përgjegjëse për menaxhimin e emergjencave në nivel komunal, bënë ngritjen e standardeve të Gatishmërinë Civile dhe Reagimit Emergjent brenda territorit dhe bënë koordinimin e subjekteve relevante për reagim në Situata Emergjente, varësisht nga karakteri dhe përmasat e fatkeqësisë. DMSH-ja merr masa të nevojshme për parandalimin e fatkeqësive si dhe përcjell vazhdimisht aktivitetet e subjekteve relevantë që janë të përfshira në rastet emergjente.

Aktivitetet e drejtorisë janë të vazhdueshme dhe të pa parashikuara sipas intensitetit që mund të ndodhin nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera brenda vitit.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH) për vitin 2019 planifikon bëjë këto aktivitete:

1. DMSH-ja vazhdon të mbajë gatishmërinë e reagimit emergjent në nivel të duhur, dhe së bashku me institucionet tjera përkatëse, merr veprimet e duhura në kohë, në rastet e situatave emergjente;
2. Do të bëhen trajnime dhe aftësi profesionale të zyrtarëve sipas planit që organizon AME në qendrën e trajnimit në Vushtrri;
3. Pajisjet Teknike për reagim emergjent, do të vazhdohet të mirëmbahen sipas kriterëve teknike në mënyrë që intervenimet të jenë sa më efikase.
4. Këtë vit është e nevojshme që të bëhet rishikimi dhe plotësimi i Planit të Vlerësimit të Rreziqeve, në baze të dinamikës së investimeve ndodhur viteve të fundit në infrastrukturë në publik dhe atë privat. Me këtë rishikim ne do të identifikojmë edhe faktorët të mundshëm që ndikojnë në dhe shtimin e rreziqeve të reja.
5. Do të inspektohet vazhdimisht gatishmëria emergjente si: institucioneve publike, ndërmarrjet private, në mënyrë që të mbahet nën kontroll gatishmëria e tyre për përballje me Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera;
6. DMSH do të bëjë koordinimin e duhur dhe do të bashkëpunojë ngushtë me organet e caktuara si: Zyrën e Kryetarit, FSK-ne, PK-në, KFOR, QKMF, Kryqin e Kuq, Drejtorinë për Shërbime Publike, Drejtorinë për Urbanizëm, Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenien Sociale si dhe organizatat e ndryshme joqeveritare. në qëllim të ngritjes së kapaciteteve reaguese në kohë në rastet në mundshme të fatkeqësive natyrore;
7. Do të organizohen kurse, ligjërata dhe ushtrime fushore në bashkëpunim me subjektet tjera me qëllim të ngritjes së kapaciteteve reaguese dhe menaxhuese të njësive të reagimit emergjent dhe vetëdijesimit të qytetarëve për reagim në rast të fatkeqësive natyrore;

8. Gjatë periudhës verore kur kemi ngritje të temperaturave të larta, shtohen rreziqet nga përhapja e zjarreve, DMSH do të ngritët niveli i mobilizimit të përgjithshëm, sidomos stafit të DMSH-së,SHZSH-së. Në kuadër të këtij mobilizimi, do të bëhet fushat vetëdijësuese me qytetarët përmes komunikimit të drejtpërdrejt, përmes këshillave të lagjeve dhe fshatrave, përmes afisheve dhe mediave, me qëllim të vetëdijesimit në parandalimin e zjarreve fushore dhe pyjore;
9. Do të mbikëqyren terrenet në përgjithësi, fokus do të jenë terrenet ku rrezikojnë shembje të dheut, në mënyrë që të vlerësohet me kohë rrezikshmëria dhe të merren masat nga organet përkatëse në parandalimin paraprak të ndonjë fatkeqësie të mundshme;
10. Do të organizojmë trajnime në mbrojtjes nga zjarri në të gjitha shkollat e Komunës së Gjilanit, me nxënësit, personelin shkollor dhe stafin teknik që ata të jenë të gatshëm t'i përdorin dhe të jenë reaguesi i parë deri sa ekipet tona të jenë në vend-ngjarje;
11. Do të organizohen trajnime për këshillat e fshatrave dhe lagjeve me qëllim të ngritjes së njohurive për reagim dhe menaxhim të situatave emergjente;
12. Për shkak të rritjes së numrit të objekteve të larta, planifikojmë furnizimin me auto shkallë për njësinë e SHZSH;
13. Do të punohet në krijimin dhe funksionalizimin e Qendrës Operative Emergjente Komunale (QOEK).
14. Do të punohet në funksionalizimin dhe shtimin e pikave të reja të Hidrantëve publik për furnizim me ujë dhe nevojave tjera emergjente për SHZSH, etj.

Përveç detyrave të parapara në këtë plan DMSH-ja, do të angazhohet në të gjitha detyrat tjera të cilat mund të paraqiten por të cilat nuk mund të parashihen për shkak të natyrës së punës dhe dukurive të paparashikueshme.

Realizimi i planit të punës të DMSH, në nivelin operativ është i ndërlidhur me Sektorin e Preventivës (SP), dhe me Shërbimin e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit (SHZSH). Këto dy sektorë të reagimit emergjent gjithashtu planifikojnë aktivitetet e tyre vjetore të cilat janë në harmoni me objektivat dhe planin e DMSH-së si dhe të AME-së.

Plani i sektori të preventivës, është i orientuar kryesisht në realizimin e objektivave të bazuar në detyrimet ligjore dhe në suaza të kompetencave që burojnë nga ligjet që e rregullojnë këtë sektor. Mbi bazë të këtyre SP planifikon:

1. Kontrollë të objekteve të kategorisë së parë së paku një herë në vit sipas nevojës edhe më shpesh;
2. Kontrollë të objekteve të kategorisë së dytë, një herë në dy vite,( është obligim të kontrollohen);
3. Kontrollë të objekteve të kategorisë së tretë një herë në tri vite, e sipas situatave edhe më shpesh;
4. Edhe gjatë vitit 2019, prioritet i shërbimit të preventivës në kontrollimin e masave për mbrojtje nga zjarri do t'i kushtohet shkollave, spitaleve, PTK, ambulancave shëndetësore, enteve parashkollore, stacioneve e derivateve të naftës, KEDS-it, palestrave sportive, qendrave të mëdha tregtare dhe të gjitha objektet ku tubohen numër i madh njerëzish;

5. Në territorin e komunës veprimtarinë e tyre e zhvillojnë një numër i madh i stacioneve (pompave) të benzinës në kuadër të cilave kanë të vendosura edhe depozita gazi, kjo ka të bëjë me rritjen e rrezikut nga zjarret dhe rrezikimit të jetës së njerëzve dhe pronës, prandaj sektori i preventivës prioritet më të madh të kontrollit do t'i kushtoj këtyre objekteve, me qëllim të zvogëlimit të rrezikut nga shpërthimi i zjarreve në këto objekte si dhe funksionimit të pajisjeve, pajimeve dhe aparateve për parandalimin, evitimin e shkaktarëve dhe përhapjes së zjarrit, qofshin ato pajisje lëvizëse ose aparate lëvizëse për shuarjen e zjarrit sikur edhe ato stabilimente fikse për parandalimin dhe evitimin e shkaktarëve të mundshëm të zjarreve (hidrantët, pajisjet fikse për shkarkimin e elektricitetit statik- rrufe pritësit e ndryshëm apo sondat e ndryshme dhe pajisjeve tjera si detektor të hershëm për lajmërimin e zjarreve në ambiente të mbyllura dhe të hapura.

I tërë ky aktivitet i sektorit të preventivës ka për qëllim ruajtjen e jetës së njerëzve, pasurisë shoqërore dhe asaj private, shtazëve dhe mbrojtjen e ambientit.

Sektori i Preventivës është në gjendje gatishmërie 24 ore dhe operon në të gjitha incidentet që lidhen me natyrën e punës së këtij sektori.

Gjithashtu si punë e përditshme e këtij sektori janë edhe komunikimi me qytetarë, hartimi i proces verbaleve nga vend incidenti, raportet mbi zjarrin, vërtetimet mbi shkaqet zjarreve.

Për Njësinë Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit për vitin 2019 është planifikuar aktivitet: në ngritjen e dijes profesionale të zjarrfikësve, përveç organizimit të trajnimeve në QTI në Vushtrri , nuk do të mungojë as angazhimi i NjPZSh për njohuri shtesë , përmes trajnimeve mobile, si ato teorike dhe praktike në shërbim ngritjes së kapacitetëve profesionale. Për AME-QTI, do të bëhet planifikim i personelit të cilët ndjekin trajnimet e ndryshme gjatë viti 2019. Përveç obligimeve me punët ditore personeli i ndërrimeve do të angazhohen edhe me trajnime mobile, teorike dhe praktike sipas planit vjetor të paraparë për vitin 2019 si vijon:

Janar - Taktika e Zjarrfikësve :

- Djegia dhe Proqesi i djegies, ( Teori )
- Kushtet elementare për djegie ( Teori )
- Mjetet për Fikje ( Teori )
- Zjarret dhe Llojet e zjarreve , ( Teori )
- Bekdrafti - Flash Over
- Identifikimi i Materieve të Rrezikshme, ( Teori )

Shkurt - Teknika e Zjarrfikësve:

- Pajisjet Personale,
- Pajisjet per Shuarje me ujë
- Pajisjet për shuarje me shkumë kimike dhe ajrore
- Pajisjet për ngjijtje në lartësi (Shkallët dhe llojet e tyre )
- Pajisjet për Aksidente të Komunikacionit Rrugor (AKRR),

Mars -Teknika e Zjarrfikësve:

- Pajisjet për Shpëtim
- Pajisjet Mbrojtëse ( Rrobot ,Aparatet e frymëmarrjes BD-96 )
- Pajisjet teknike
- Pajisjet për Zhytje në ujë,
- Pajisjet për ndriçim dhe
- Pajisjet Sanitare etj.
- Vendosja e pajisjeve të zjarrfikjes
- Shpëtimi dhe evakuimi etj.

#### Prill – Ushtrime Praktike

- Përsëritja e përdorimit të Teknikës së Zjarrfikësve në Praktikë
- Shpejtësia e daljes së ekipit për intervenim,
- Ushtrime -Aksion i kombinuar,
- Ushtrime -Aksion në katet e ndërtesave me anë të shkallëve,
- Ushtrime- Me Pajisjet AKRR,
- Ushtrime –Përdorimi i Shkumës Ajrore

Maj - Vazhdimi i ushtrimeve dhe punëve të cekura më poshtë.

Qershor - Vazhdojnë Ushtrimet dhe puna për përgatitje për ndonjë ushtrim për nderë të Ditës së Zjarrfikësve, apo ndonjë manifestimi tjetër.

#### Korrik, Gusht dhe Shtator

Për shkak të intervenimeve të shumta që mund t'i kemi gjatë sezonit, nuk parashohim ndonjë angazhim tjetër pos mobilizimit më të madh;

Tetor - Vazhdojmë me ushtrime, Përdorimi i AF, Pajisje për AKRR dhe përsëritja e temave të zhvilluara nga Taktika e zjarrfikësve .

Nëntor - Përsëritja dhe vazhdimi me teknikën, taktikën e zjarrfikësve,

- përgatitja e automjeteve për sezonin e dimrit.

Dhjetor-Vlerësimi i punëtorëve mbi punën dhe aftësimin profesional ,

- Përgatitja e raporteve për vitin kalendarik.
- Përgatitja e planit të punës për vitin vijues,
- Planifikimi, deklarimi mbi shfrytëzimin e pushimeve vjetore për vitin vijues.

Po ashtu do të bëjmë mbushjen e bombolave të Aparateve të frymëmarrjes, jo vetëm për njësinë tonë por, edhe për njësit tjera të regjionit : NjPZSh- Dardanës, NjPZSh Vitisë, NjPZSh –Novobërdës .

Gjatë vitit 2019 planifikojmë disa punë shtesë siç janë:

1. Riparimi i disa defekteve të imta të automjetit Tojota dhe automjeteve tjera
2. Lyerja e nyjave te automjeteve ( punë e rregullt për fillim të sezonës verore)
3. Kontrollimi detal për përgatitjen e automjeteve për regjistrim BMC-5,6
4. Vazhdimin e punëve të mbetura në objekt brenda-dhe deyrte e garazhit te aneksi i objektit .
5. Rregullimi i një gjysmë fushe për aktivitete sportive mbrapa
6. Rregullimi i semeringave në pompat statike në BMC- 6,
7. Kontrollimi detal për përgatitjen e automjeteve FAP-4, Iveko 1-2 Tojota , Nisani për regjistrim ( Korrik )
8. Përkushtim rreth vazhimit të realizimit të projekteve (vazhdimi i Garazheve).

## DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik (DZHE) në kuadër të Komunës së Gjilanit ka një rol kyç në planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë së zhvillimit, siguron koordinim vertikal dhe horizontal dhe komunikim me të gjithë aktoret relevantë në proces, si brenda administratës komunale ashtu edhe me nivelin qendror, komunitetin dhe më gjerë.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, do të punojë sipas planit të punës të përgatitur në mënyrë profesionale dhe do të ndërmarrë veprime të përcaktuara qartë dhe harmonizuara me objektivat strategjike të Strategjisë Zhvillimore Komunale (përfshirë Strategjinë për Zhvillim Socio Ekonomik dhe Strategjinë për Gratë Ndërmarrëse 2017-2021) si dhe dokumente tjera programore që kanë për qëllim ndikimin në përmirësimin dhe avansimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik lokal. Ky plan është një përpjekje për të ndikuar në uljen e papunësisë përmes krijimit të një klime të favorshme të të bërit biznes, veprim ky i cili do të ndikojë në ngritjen e standardit të jetesës të të gjithë qytetarëve të Komunës së Gjilanit.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik do të ndërmarrë iniciativa të cilat qojnë në arritje të rezultateve konkrete dhe do t'i kushtohet vëmendje komunikimit konstruktiv me të gjitha institucionet relevante në nivel lokal dhe qendror, me donatorë, si dhe investitorë potencial të huaj dhe vendor. Po ashtu do t'i ofrohet mbështetje bizneseve fillestare dhe atyre ekzistuese të vogla e të mesme përmes aktiviteteve trajnuese, këshilluese duke përfshirë edhe promovimin e bizneseve lokale. Një aktivitet kyç i kësaj drejtorie do të jetë inkurajimi i krijimit të bizneseve të reja duke ofruar shërbime bizneseve sidomos atyre fillestare në përgatitjen e aplikacioneve për thirrje për grante nga burimet e ndryshme financiare.

Një synim tjetër ku do të kemi çasje pro aktive do të jetë joshja e investitorëve vendor dhe të huaj përmes ofrimit të informatave profesionale relevante. Në anën tjetër do të identifikohen bizneset të cilat kanë interesim për të zgjeruar aktivitetin e tyre biznesor dhe për të hyrë në partneritet me investitorë potencial.

Fokus i veçantë do të kushtohet edhe përgatitjes së studimeve të arsyeshmërisë për projekte të investimeve kapitale si dhe rishikimit dhe zhvillimit të projekt koncepteve për PPP përfshirë promovimin e tyre duke pasur parasysh investimet e mëdha në fushën e infrastrukturës e sidomos sa i përket trajtimit të ujërave të zeza, efijencës së energjisë, energjisë së ripërtrishme, infrastrukturës biznese, zhvillimit të produkteve të reja turistike përfshirë infrastrukturën përcjellëse etj.

DZHE do të jetë e kyçur aktivisht edhe sa i përket implementimit të të gjitha projekteve të financuara nga ana e donatorëve të ndryshëm me qëllim të koordinimit të aktiviteteve dhe maksimizimit të efektit të rezultateve të pritshme, e në të njëjtën kohë do të angazhohet

edhe për identifikimin e donatorëve të mundshëm potencial në rastet dhe projektet që mund të identifikohen në ndërkohë gjatë këtij mandati.

Projekti më i rëndësishëm i planifikuar për këtë vit është realizimi i projektit për ndërtimin e Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza si dhe infrastrukturës përcjellëse në komunën e Gjilanit, projekt ky i cili kap vlerën prej rreth 22 milion euro.

## **MISIONI**

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka si mision mbështetjen e procesit të hartimit dhe zbatimit të politikave të qeverisë lokale, për një zhvillim të integruar të sektorëve prioritarë të ekonomisë, përmes dhënies prioritet dhe rritjes së efektivitetit të investimeve publike, nxitjes së bashkëpunimit lokalë dhe rajonal që ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara në fushën e zhvillimit ekonomik lokal. Përmirësimi i jetesës së qytetarëve dhe rritja e efikasitetit të shërbimeve të ofruara në fushën e zhvillimit ekonomik lokal mbetet fokusi kryesor i kësaj drejtorie.

## **OBJEKTIVAT KRYESORE TË PUNËS**

- Në bashkëveprim me Kryetarin e Komunës dhe Institucionet tjera Komunale, do të synojmë realizimin e strategjisë zhvillimore lokale e cila është e bashkërenditur me atë qendrore, duke përfshirë të gjithë sektorët e ekonomisë, si në aspektin afat-shkurtër ashtu edhe në atë afat-gjatë,
- Hulumtimin e mundësive për të siguruar donacione dhe burime të tjera financiare për realizimin e projekteve zhvillimore,
- Hartimin e programeve sipas veprimtarive dhe sektorëve të ndryshëm ekonomik, dhe përgatitjen e propozimeve konkrete për projekte të rëndësishme të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e sektorëve të veçantë,
- Ofrimin e trajnimeve të dizajnuara sipas kërkesave dhe nevojave të bizneseve si dhe këshilldhënie lidhur me mundësitë për të investuar kapitalin e tyre në veprimtaritë prodhuese dhe ku janë mundësitë më të mira për të kthyer investimin e bërë dhe avancimi i bizneseve dhe aktiviteteve të tyre biznesore,
- Ofrimin e shërbimeve për regjistrimin e bizneseve - Qendra e Regjistrimit të Bizneseve
- Bashkëpunimi dhe koordinimi i projekteve lidhur me Partneritet Publiko Privat,
- Bashkëpunimin me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe digastereve tjerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës rreth mundësive dhe koordinimit të aktiviteteve lidhur me realizimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal,
- Bashkëpunimin me Institucionet Ndërkombëtare dhe organizatave të ndryshme financiare për projekte të ndryshme zhvillimore e sidomos në projekte të investimeve kapitale,
- Koordinimi dhe bashkëpunimi me Organizatat jo Qeveritare që mund të përkrahin me projektet ideore të cilat kanë në fokus promovimin dhe zhvillimin ekonomik lokal,

- Bashkëpunimi i ngushtë me bizneset lokale lidhur me përmirësimin e klimës për të bërë biznes ,
- Koordinimi dhe mbikëqyrja e realizimit të projekteve – bashkëfinancimi i projekteve të financuara në pjesën më të madhe nga donatorët, qeveria dhe komuniteti - Zotimet ndaj marrëveshjeve të nëshkruara,
- Përcjellja dhe zbatimi i politikave dhe programeve zhvillimore, planeve vjetore dhe strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal dhe regjional - duke përfshirë edhe bashkëpunimin ndërkufitar
- Organizimi ose bashkë-organizimi i konferencave të ndryshme për promovimin e mundësive për investime në Komunën e Gjilanit,
- Organizimin e panireve për promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve,
- Komunikimin e vazhdueshëm me investitor potencial vendor dhe të huaj përfshirë diasporën me qëllim të informimit lidhur me lehtësirat, planet zhvillimore, projektet dhe mundësitë praktike që ofron Komuna në raport me investitorët,
- Komunikim i vazhdueshëm për të tërhequr investitorë duke prezantuar mundësitë për investime në projekte infrastrukturore si: trajtimi i ujërave të zeza, eficientia e energjisë, burimet e ripërtëritshme të energjisë, parkingje publike etj. Përfshirë edhe projekte të kompanive private të cilët janë të interesuar për investime të përbashkëta me partner ndërkombëtar.
- Promovimin e potencialeve turistike të komunës së Gjilanit në ndërlidhje me pakot e mundshme turistike në bashkëpunim me komunat tjera të rajonit.

Të gjitha veprimet, politikat dhe procedurat dokumentohen përmes:

- Raporteve periodike (muajore, gjashtë mujore dhe vjetore)
- Strategjive Zhvillimore Lokale

SYNIMET DHE OBJEKTIVAT PËR VITIN 2019	
Synimet	Objektivat
Zhvillimi i bizneseve sektorit agro – përpunues dhe stimulimi i ndërmarrësisë	Promovimi i zhvillimit (ri-kthimit) të industrisë së duhanit.
	Rregullimi i infrastrukturës rrugore për bizneset përmes kodit të bashkë-financimit
	Inkurajimi i ndërmarrësisë dhe përkrahja e të rinjve në bujqësi përmes asistencës dhe qasjes te donatorët
Ofrimi i shërbimeve publike përmes partneritetit publiko privat	Krijimi i zonës ekonomike
	Investimi në kopshtet për fëmijë
	Realizimi i studimeve të fizibilitetit për projekte infrastrukturore

	Palestra e sporteve "Bashkim Selishta – Petriti"
	Ndriçimi publik
	Stadiumet e futbollit
	Funksionalizimi i Inkubatorit të biznesit
	Përkrahja e bizneseve
Përmirësimi i Infrastrukturës fizike	Rehabilitimi i sistemit të kanalizimit për ujërat e zeza.
	Zbatimi i projektit të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza si dhe infrastrukturës përcjellëse
	Modernizimi i tregut të gjelbër
Zbatimi i Planit të Veprimit për Energji të Oëndrueshme	Fillimi i procedurave për gjetjen e burimeve të financimit për ndërtimin e impiantit për djegjen e mbeturinave dhe prodhimin e energjisë.
	Efiçienca e energjisë nëpër shkolla dhe institucionet publike

<b>Përshkrimi i Projektit</b>	<b>Periudha</b>	<b>Komente</b>
Modernizimi i Tregut të Gjelbër	Mars-Tetor	Projekti i financuar nga BE (pjesa e shitjes) nga programi IPA i bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet Gjilanit dhe Kumanovës dhe me bashkë-financim
Programi i Efiçencës së Energjisë në Ndërtesat Publike	Janar-Dhjetor	Ky program vazhdon nga viti i kaluar, pasi që ka pasur një ngecje nga ana procedurale në mes të Ministrisë së Financave dhe KfW (Bankes Gjermane). Aktualisht KfW është në proces të shqyrtimit të ri-tenderimit.
Rehabilitimi dhe instalimi i kanalizimeve të ujërave të zeza, si dhe rregullimi i shtratit të lumit Mirusha dhe Stanishorka	Mars-Tetor	Komuna ka vazhduar punimet në lumin Mirusha. Lumi Stanishorka do të trajtohet si pjesë e projektit Impianti për trajtimin e ujërave të zeza dhe zbatimi i tij pritet të filloj në Shtator 2019
Palestra e Sporteve - PPP	Qershor	Të ri-shikohet studimi i fizibilitetit dhe të dërgohet për shqyrtim dhe miratim në Komitetin për PPP
Ndërtimi i çerdheve	Qershor	Çerdhja në lagjen "Arbëria" pritet të ndërtohet nga BE dhe MASHT. Projekti është në fazën e dizajnit dhe projektimit nga BE.
Funksionalizimi i tregut të kafshëve, veturave dhe tregjeve të tjera nën menaxhimin e kompanisë NPL "Tregu"	Janar-Dhjetor	Të sigurohet vendi adekuat për tregjet e përmendura si dhe burimet e financimit.
<b>Përshkrimi i Aktivitetit</b>	<b>Periudha</b>	<b>Komente</b>
Ekzaminimi, mbledhja e të dhënave për ekonominë e Komunës	Dhjetor	Të dhënat do të shërbejnë për qëllim të planifikimit sa më të drejtë, përcjellës së trendeve të zhvillimit si dhe të informimit për nivelin e zhvillimit të komunës etj.
Identifikimi, zhvillimi i projekteve të reja	Permanent	Varësisht nga Thirrjet për Projekt Propozime nga burime të ndryshme të financimit (qeveri dhe /ose donatorë) do të përgatiten projekte për aplikim
Mbështetje e të rinjve në ndërmarrësi	Mars-Shtator	DZHE bashkë-financon skemën e granteve në formë të pajisjeve me donatorë (organizata Gjermane "Help")

Organizimi i Panairit Regjional të Ndërmarrësisë	Korrik-Shtator	Panairi regjional me mundësi të përfshirjes së bizneseve nga zonat kufitare
Konferenca për promovim të mundësive për investime në komunë	Prill-Dhjetor	Me Ministritë dhe /ose bizneset nga diaspora dhe ato vendore
Përditësimi i web faqes së komunës me informata të rëndësishme për aktivitetet e DZHE dhe në interes të publikut të gjerë	Janar-Dhjetor	DZHE në bashkëpunim me Zyrën për Informim
Mbështetje të rinjve përmes ngritjes së kapaciteteve të tyre për punë si dhe inkurajimi i ndërmarrësisë	Janar-Shtator	DZHE në bashkëpunim me USAID
Projekti për trashëgimi kulturore dhe ngritja e kapaciteteve të grave për shkathtësi të punës dhe artizanate	Janar-Qershor	Projekti i financuar nga BE nga programi IPA i bashkëpunimit ndërkufitar KS-MK dhe implementohet nga OJQ "Open Door"

*Shënim: Plani i Punës për vitin 2019 nuk përfshin aktivitetet rutinore të DZHE*

## DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Në kuadër të përgjegjësisë të saja, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, planifikon këto aktivitete kryesore gjatë vitit 2019:

Aktiviteti	Data	Vendi	Objektivi	Përgjegjësia	Veprimet
<b>Flaka e Janarit 2019</b>	11-31.01.2019	Teatri i Qytetit Gjilan	Manifestimi "FLAKA E JANARIT" 2019 është tradicional tashmë dhe numëron edicionin e tij të 28. Objektivi i tij është që të ruajë dhe rrisë vlerat e artit të mirëfillte shqiptar. Të	Përgjegjës teknik të organizimit janë DKRS- Gjilan, këshilli i flakës,  Zyra e Kryetarit L.Haziri,	Organizimi bëhet nën koordinimin e DKRS dhe Zyren e Kryetarit të Komunes. zLutfi Haziri në bashkëpunim me

			mbledhë artist nga të gjitha trojet shqipfolëse dhe të begatojë bagazhin e tyre artistik.		këshillin artistik të Flakës
<b>Shpallja e Pavarësisë së Kosovës</b>	17.02.2019	Salla e Teatrit të qytetit,  Platoja para Teatrit	Qëllimi i këtij aktiviteti të rëndësishëm është të rikujtojë dhe shënojë njëkohësisht festën e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe të ngrisë lartë vlerat tona shtetërore.	Përgjegjës teknik të organizimit janë: DKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit L.Haziri,	Organizimi bëhet nga DKRS, në bashkëpunim me komunitetin kulturor të qytetit.Shkolla e Muzikës, Kori i Fëmijëve etj.
<b>Dita e Dëshmorëve</b>	5-6.03.2019	Kodra e Dëshmorëve	Qëllimi i këtij aktiviteti është të rikujtojë dhe respektojë të rënët e vendit.	Përgjegjës teknik të organizimit janë: DKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit, Shoqata e OVL te UCK-se	Organizimi bëhet nga Shoqata e OVL të UÇK-së nën koordinimin e DKRS
<b>Vrapimi i Qytetit "Gjilani 2019"</b>	11.09.2019	Para Teatrit të Qytetit	Ky eveniment sportiv mbahet për nderë të demonstratave të vitit 1981.	D.K.R.S- Federtata e Atletikes së Kosovës	
<b>Turniri i boksit "A. Rashiti"</b>	23.03.2019	Palestra e Sporteve	Turnir memorial në Boks	D.K.R.S- Klubi i Boksit DRITA	
<b>Beteja e Zhegocit</b>	15.04.2019	Zhegoc	Qëllimi i këtij aktiviteti është të kujtojë të rënët e kësaj zone për liri.	Përgjegjës teknik të organizimit janë:Keshilli i Fshatit Zhegoc. DKRS- Gjilan,	Organizimi bëhet nga Keshilli i Fshatit Zhegoc, nën koordinimin e DKRS .

<b>"Ditët e Agimit "</b>	1-3.05.2019	Zheger	Qëllimi i këtij aktiviteti është të kujtojë dëshmorin Agim Ramadani..	Përgjegjës teknik të organizimit janë:Keshilli i Fshatit Zheger. NJKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit	Organizimi bëhet nga Keshilli i Fshatit Zheger, nën koordinimin e DKRS dhe Zyrën e Kryetarit .
<b>"LYRA FEST"</b>	01.06.2019		Qëllimi i këtij aktiviteti është të shënojë Ditën ndërkombëtare të fëmijëve'.	Përgjegjës teknik të organizimit janë stafi i "Lyra Fest"	Organizimi bëhet nga "Lyra Fest", nën koordinimin e DKRS
<b>Çmimi Letrar "BEQIR MUSLIU"</b>	11.06.2019	Salla e Kuvendit	Qëllimi i këtij aktiviteti është të shpërblejë autorët për veprat e tyre jetësore.	Përgjegjës teknik të organizimit janë:Ars Club "BEQIR MUSLIU" DKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit,	Organizimi bëhet nga Ars Clubi 'BEQIR MUSLIU' nën koordinimin e DKRS dhe Zyrën e Kryetarit
<b>Trekëndëshi poetik i Paqes</b>	13.06.2019	Zheger		Përgjegjës teknik të organizimit janë:Ars Club "BEQIR MUSLIU" DKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit,	Organizimi bëhet nga Ars Clubi 'BEQIR MUSLIU' nën koordinimin e DKRS dhe Zyrën e Kryetarit
<b>Dita e Çlirimit të Gjilanit</b>	15.06.2019	Sheshi para Teatrit	Qëllimi i këtij aktiviteti është te rikujtoje dhe shenoje Ditën e Çlirimit të Qytetit nga pushtuesi dhe të ngrisë lartë vlerat tona kombëtare.	Përgjegjës teknik të organizimit janë: DKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit	Organizimi bëhet nën koordinimin e DKRS dhe Zyren e Kryetarit te Komunes.zLutfi Haziri.
<b>Takim me të dalluarit e vitit</b>	20.06.2017	Salla e Teatrit	Qëllimi i këtij aktiviteti është të promovojë të arriturat gjatë tërë vitit nga të Rinjte, Artistët dhe Sportistët e qytetit tonë.	Përgjegjës teknik të organizimit janë: DKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit L.Haziri,	Organizimi bëhet nën koordinimin e DKRS dhe me Zyrën e Kryetarit të Komunes në bashkëpunim me komunitetin artistik e sportiv të qytetit,
<b>"DITËT E MËRGATES"</b>	05.07.2019	Sheshi para Teatrit	Qëllimi i këtij aktiviteti është që në mënyrë sa më të mirë të mundur të urojmë qëndrim e bashkatdhetarëve tanë nëpërmjet aktiviteteve kulturore e sportive.	Përgjegjës teknik të organizimit janë: DKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit L.Haziri,	Organizimi bëhet nën koordinimin e DKRS dhe Zyrën e Kryetarit te Komunes.zLutfi Haziri ne bashkëpunim me komunitetin artistik

<b>Dita e rinisë</b>	12. 08. 2019	Shtëpia e rinisë			të qytetit,
<b>Panairi i Sportit "Gjilani 2019"</b>	15.09.2019	Para platos së Teatrit	Qëllimi i këtij aktiviteti është që fëmijët të jenë sa më afër sportit.	D.K.R.S- Komiteti Olimpik	
<b>Vjeshta Letrare</b>	11.10.2019	Salla e Kuvendit Komunal	Aktivitet i përvitshëm i Ars Club "BEQIR MUSLIU" në bashkëpunim me dashamirë të letrave, shkrimtarë dhe poetë .  Promovimi i vlerave letrare dhe i artistëve të rinjë.	Përgjegjës teknik të organizimit janë: Ars Club "BEQIR MUSLIU" DKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit,	Organizimi bëhet nga Ars Clubi "BEQIR MUSLIU" nën koordinimin e DKRS dhe Zyren e Kryetarit
<b>Salloni i Gjilanit</b>	20.10.2017	Galeri e Qytetit	Aktiviteti i përvitshëm	Përgjegjës teknik të organizimit janë Shoqata e Artit Pamor DKRS-	Organizimi bëhet nga Shoqata e Artit Pamor nën koordinimin e DKRS .
<b>Dita e bibliotekës Përvjetori</b>	19.10.2019	Biblioteka,	Shënimi i 81 vjetorit të punës, me aktivitete të ndryshme.  Turneu i 14-të me radhë  Festivali i 6-të me radhë	Përgjegjës teknik të organizimit janë: DKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit L.Haziri,  DKRS dhe sektori i sportit  Sekt. Kulturës	Organizimi bëhet nga Biblioteka "FAN STILIAN NOLI", nën koordinimin e DKRS
<b>Turniri "Katana open"</b>	25.10. 2019	Palestër			
<b>Festival i fëmijëve MOLLËKUQJA</b>	22- 23. 10. 2019	TEATËR			
<b>Darka e Lamës</b>	27.11.2019	Restorant	Darka e Lamës është një festë e lashtë e falënderimit	Përgjegjës teknik të organizimit janë:	Organizimi bëhet nën koordinimin e

			të Zotit për frytet e punës dhe të korrat e vitit. Nga një festë tradicionale e mori peshën që i takonte në vitin 2002 kur Presidenti Ibrahim Rugova e shpalli festë shtetërore	Drejtoria e Bujqësisë - Gjilan, Zyra e Kryetarit L.Haziri	Drejtorise së Bujqësisë dhe Zyrën e Kryetarit të Komunes.z Lutfi Haziri.
<b>Festa e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë "28 Nentori"</b>	28.11.2019	Salla e Teatrit	Qëllimi i këtij aktiviteti të rendësishëm është të rikujtojë dhe shënojë njëkohsisht festën tonë kombëtare të Flamurit, Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe të ngrisë lartë vlerat tona kombëtare.	Përgjegjës teknik të organizimit janë: DKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit L.Haziri,	Organizimi bëhet nën koordimnin e DKRS dhe Zyren e Kryetarit të Komunes.zLutfi Haziri në bashkëpunim me komunitetin artistik të qytetit,
<b>Festivali i këngës për Fëmijë "DËBORA"</b>		Salla e Teatrit	Aktiviteti i përvitshëm tashmë edicioni i IV-të i organizuar nga Besart Berisha, ka për qëllim prurje të reja nga shkrimtarë, kompozitorë dhe këngëtarë të vegjël dhe avancimin e muzikës për fëmijë.		DKRS e ndihmon
<b>Ndriçimi i qytetit</b>	02.12.2018	Sheshi dhe pjesët të caktuara të qytetit	Qëllimi i këtij aktiviteti është shënimi i ndërrimit të moteve,	Përgjegjës teknik të organizimit janë: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Zyra e Kryetarit.	
<b>Ekspozita Kolektive "Salloni i Gjilanit"</b>		Galeria e qytetit	Aktiviteti i përvitshëm i organizuar nga Shoqata e Artit Pamor në të cilin bashkohen shumë artistë nga mbarë trojet shqiptare me qëllim të promovimit të vlerave të mëdha të artit pamor.	Përgjegjës teknik të organizimit janë Shoqata e Artit Pamor DKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit,	Organizimi bëhet nga Shoqata e Artit Pamor nën koordimnin e DKRS dhe Zyrën e Kryetarit
<b>Festa e Fundvitit</b>	31.12.2019	Sheshi para	Qëllimi i këtij aktiviteti është shënimi i ndërrimit të	Përgjegjës teknik të organizimit janë:	Organizimi bëhet nën koordimnin e

		Teatrit	moteve, me anë të performimit të artistëve të qytetit.	DKRS- Gjilan, Zyra e Kryetarit L.Haziri,	DKRS dhe Zyrën e Kryetarit te Komunës.zLutfi Haziri në bashkëpunim me komunitetin artistik të qytetit,
--	--	---------	--	--	--

### TEATRI I QYTETIT PËR VITIN 2019

Gjatë këtij vitit duhet të realizoj katër (4) shfaqje për të rritur dhe një për fëmijë. Reprizat, shfaqjet mysafire, udhëtimet në festivale të ndryshme.

Drejtorja e KRS ndanë mjete nga subvencionet për realizimin e projekteve-shfaqjeve nga reportoari i tyre.

#### ***Të paparashikuara:***

Kemi aktivitete që dalin ad-hoc, shënimi i ndonjë përvjetori, vizita e ndonjë mysafiri, organizimi i ndonjë tryeze, debati, trajnimi, udhëtimi. Vizita e ndonjë delegacioni, lojë miqësore me sportistë të tjerë. Përkrahja e ndonjë individi të suksesshëm, përfaqësimi jashtë vendit dhe ndonjë aktivitet tjetër.

## DREJTORIA E INSPEKSIONIT

### INSPEKSIONI I NDERTIMIT

Gjatë vitit 2019 do të zbatohet ligjet në fuqi si Ligjin i Ndërtimit 04/L-110, Ligjin 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrë, Planifikim hapësinor dhe Ndërtimit, Udhëzimin Administrativ 05/2017 të MMPH-se, Udhëzimin Administrativ MMPH-nr.20/2013 për Mënyrën, Procedurën dhe Shumën e Gjjobave ndaj Pjesëmarrësve në Ndërtim, Udhëzimi Administrativ 08/2013 për Ndërtimet për të cilat nuk kërkohet leje ndërtimore.

Gjatë vitit kalendarik 2019, do të përqendrohemi në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi:

- Inspektim të rasteve në proces të ndërtimit,
- Hartim të procesverbaleve-ndërprerje të punimeve pa leje ndërtimore,
- Dorëzim të vendimeve për ndërprerje të punëve,
- Pranim-shqyrtim të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve,
- Shqiptim i gjjobave ndaj kundërvajtësve,
- Inicim të procedurave gjyqësore për kundërvajtje,
- Vendim për rrënim
- Shqyrtimi i kërkesave të palëve etj.

Nga e gjithë kjo që u cekë më lartë nevojitet të kemi mbështetje institucionale në rend të parë si dhe të kemi trajnime nga institucionet përkatëse për trajnim në seminare të ndryshme për t'u njohur sa ma mirë me ligjet dhe zbatimin e tyre etj.

### INSPEKTORËT E TREGUT

Gjatë vitit 2019 do të zbatohet ligjet në fuqi si Ligjin mbi tregtinë e brendshme nr.2004\18, Ligjin për Inspektoratin e tregut nr.03\L-181, Ligjin për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit nr.04/L-039 .Ligjin për njësitë matëse nr.2004\11, Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve Nr.06/L-034, Udhëzimin administrativ nr.2005/12, si dhe Rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës.

Gjatë vitit kalendarik 2019 do të përqendrohemi në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi:

- Inspektimet e subjekteve afariste të cilat nuk janë të regjistruara në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, si dhe nuk janë të pajisura me pëlqimin e pranimit teknik nga ana e inspektorëve të tregtisë,

- kontrollimin e librave tregtare të blerjes dhe shitjes,
- pranime teknike të lokaleve afariste,
- përcjelljen e çmimeve të artikujve të ekspozuara në dyqane,
- përcjellja e dhënies së kuponave fiskal dhe faturat mbi shitjen dhe blerjen e mallit,
- përcjellja e orarit të punës të subjekteve afariste etj.
- përcjellja e zhigosjeve të peshoreve.
- përcjellja e furrave të bukës, pesha e bukë, deklaracioni i bukës si dhe zhigosja e peshoreve.
- përcjellja e orarit të punës të lokaleve afariste, zbatimi i orarit të punës në bazë të rregullores komunale.
- inspektimin e artikujve ushqimor dhe atyre jo ushqimor me afat të skaduar.

Nga e gjithë kjo që u cek më lart nevojitet të kemi mbështetje institucionale në rend të parë si dhe të kemi trajnime nga institucionet përkatse për trajnim në seminare të ndryshme për t'u njohur sa ma mirë me ligjet dhe zbatimin e tyre etj.

## **INSPEKSIONI I SHËRBIMEVE PUBLIKE, KOMUNIKACIONIT DHE I AMBIENTIT**

### ***Sfera e shërbimeve publike***

- Inspektimi i hapësirave publike për kushte të dimrit
- Inspektimi i hapësirave publike të cilat përdoren me rastin e ngarkimit dhe shkarkimit të mallit para lokaleve afariste
- Inspektimi i panove reklamuese të vendosura në hapësirë publike dhe hapësirë private
- Inspektimin e shfrytëzimit të trotuareve nga lokalet afariste pa leje dhe me leje nga kafiteritë dhe nga shitësit ambulantiv
- Inspektimi i bllokimeve të rrugëve dhe të trotuareve nga mallrat
- Inspektimi i keqpërdorimit të ujit të pijshëm
- Inspektimi i kafiterive, i shitësve ambulantiv, ej., që kanë shfrytëzuar hapësirat publike të bëjnë largimin e tyre
- Shqyrtimi i kërkesave të palëve etj.

### ***Sfera e komunikacionit***

- Inspektimi i transportit urban dhe urban-periferik me autobus dhe me minibus
- Inspektimi i operatorëve dhe i individëve që merren me bartje taksi të udhëtarëve

- Inspektimi i sinjalizimit vertikal, horizontal dhe atij me drita
- Inspektimi i mjeteve të cilat bartin materiet e rrezikshme e të ngjashme
- Inspektimi i parkimeve të automjeteve në bashkëpunim me Policinë e Kosovës
- Siguria në rrugë publike me theks në siguri të nxënësve në rrugë
- Aksione me polici për eliminimin e parregullsive në sferën e komunikacionit
- Shqyrtimi i kërkesave të palëve, etj.

### ***Sfera e mbrojtjes së mjedisit (ambientit)***

- Në mënyrë permanente zbatimi i Udhëzimit administrative nr. 06/2018 dhe
- Udhëzimi administrative 01/2017 për dhënien e lejes mjedisore komunale.
- Inspektimi permanent dhe pengimi në krijimin e deponive ilegale
- Inspektimi i autolarjeve
- Inspektimi i mishtoreve dhe fermave të pulave
- Inspektimi i fabrikave për përpunim të drurit, mobilieri, tapiceri deri 1000m<sup>3</sup>/vit
- Inspektim autoserviseve, autoserviseve me automjete jashtë përdorimi deri 20 copë
- Inspektim i furrave për prodhim të bukës dhe produkteve të tjera nga mielli
- Inspektim i ndërtimit të objekteve të banimit kolektiv dhe të shërbimeve (hoteliere, tregtare, komerciale, afariste etj.) me sipërfaqe në bazë mbi 450 m<sup>2</sup> ose në sipërfaqe totale të objektit mbi 1500 m<sup>2</sup>.
- Inspektim objekteve shërbyese për ushqime (qebaptore, ëmbëltore, gjellëtore, restorante etj.)
- Ligjërata vetëdijësuese për Mbrojtjen e Mjedisit (shkollat fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta)
- Inspektim i stacioneve të karburanteve të gazit.

### **INSPEKSIONI I BUJQËSISË, VETERINARISË DHE SANITARISË**

Në planin e punës do të përfshihet kontrolli- mbikëqyrja e kualitetit të ushqimit me prejardhje bimore dhe shtazore në subjektet afariste ushqimore, hoteliere, Inspektimi i thertoreve, mishtoreve, kontrolli i organeve të brendshme pas therjes së kafshëve në thertore. Inspektimi i institucioneve parashkollore, shkollore, inspektimi i tokave bujqësore, pengimi i degradimit të saj, si dhe përgjigje në kërkesat e subjekteve për dhënie të pëlqimit për kushtet higjieno sanitare të ordinancave dhe barnatoreve humane, marrja pjesë në komisione për monitorimin e dezinfektimit hapësinor, dezinfektimi i shkollave dhe komisione të ndryshme.

- Inspektimi i kushteve higjieno-sanitare të Institucioneve parashkollore dhe shkollore.
- Kontrolli i subjekteve afariste tregtare ushqimore nga aspekti i kontrollit higjieno sanitar dhe afatshmërisë së artikujve ushqimorë, kushteve të ruajtjes etj.
- Kontrolli i therjeve të kafshëve, damkosja e mishit dhe lejimi i tij për konsum.
- Inspektimi i degradimit të tokës bujqësore.
- Shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve për pëlqime sanitare si dhe shqyrtimi i ankesave drejtuar sektorit tonë.

- Inspektimi i subjekteve ushqimore, afatshmërinë e artikujve dhe kushtet e ruajtjes në prag të festave të fundvitit.
- Kontrollimi i dhuratave për fëmijë.

## KUVENDI DHE MEKANIZMAT KOMUNAL

Në kuadër të këtij dokumenti strategjik të qeverisjes së Gjilanit, këtu po paraqesim edhe objektivat kryesore të Njesisë së Kuvendit (ashtu që të kemi parasysh aktivitetet kyç që ndërlihen me Kuvendin Komunal), si dhe ato të Mekanizmave Komunalë/

### NJËSIA E KUVENDIT

Bazuar në Planin vjetor të punës së Kuvendit, në përshkrimin e punëve dhe detyrave të punës të secilit punëtor, duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi si dhe rregullativën komunale, Njësia e Kuvendit gjatë vitit 2019, do t'i këto aktivitetet:

Nr.	Aktivitetet	Afati realizimit
1	Zbatimi i Planit të punës të Kuvendit të Komunës së Gjilanit për vitin 2019	Detyrë permanente
2	Zbatimi i Kalendarit të seancave të Kuvendit dhe mbledhjeve të Komiteteve të KK Gjilan	Detyrë permanente
3	Përgatitja profesionale dhe teknike e seancave të rregullta të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, bazuar në Orarin vjetor për mbajtjen e seancave të KK-Gjilan, si dhe përgatitja profesionale dhe teknike e seancave të jashtëzakonshme, të cilat KK-ja do t'i mbaj sipas nevojës	Detyrë permanente
4	Përgatitja profesionale dhe teknike e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komiteteve tjera të parapara me Statutin e Komunës, bazuar në Kalendarin vjetor për mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve.	Detyrë permanente
5	Përcjellja e takimeve dhe mbajtja e procesverbaleve të KK-së dhe Komisioneve tjera të formuara nga KK-ja.	Detyrë permanente

6	Përkthimi i të gjitha materialeve të Kuvendit, Komiteteve, Bordit të Drejtorëve dhe organeve tjera komunale, si dhe përkthimi simultan i seancave të rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit, Komiteteve dhe takimeve tjera të institucioneve komunale	Detyrë permanente
7	Dërgimi i Raportit mujor në MAPL, për të gjitha aktet dhe shkresat e përkthyera të lëshuara nga Institucionet komunale	Detyrë permanente
8	Lekturimi i të gjitha materialeve të Kuvendit dhe Komiteteve, dhe Bordit të Drejtorëve, dhe materialeve e akteve tjera të KK-së	Detyrë permanente
9	Ekspedimi me kohë i të gjitha materialeve për Seancat e Kuvendit, Komiteteve dhe takimeve tjera të Institucioneve komunale, në formë fizike dhe elektronike	Detyrë permanente
10	Përgatitja teknike e Sallës së Kuvendit, kujdesi për mirëmbajtjen e aparaturës për zërim dhe incizimi përmes kamerës dhe incizimi tonik i seancave, mirëmbajtja dhe kujdesi për funksionimin normal dhe mirëmbajtjen e pajisjeve për votim elektronik	Detyrë permanente
11	Mbajtja e evidencës së vijimit të anëtarëve të Kuvendit dhe Komiteteve, me qëllim të zbatimit të Udhëzimit Administrativ Nr.16/2008 për pagesën e Stafit politik në Komunë	Detyrë permanente
12	Njoftimi me kohë për mbajtjen e seancave të KK-së, dhe dërgimi i të gjitha vendimeve, rregulloreve dhe akteve tjera në MAPL për vlerësim të ligjshmërisë bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.	Detyrë permanente
13	Dërgimi i Raporteve të rregullta mujore në MAPL për të gjitha aktet e miratuara nga KK-Gjilan	Në fund të çdo muaji
14	Dërgimi i të gjitha akteve të nxjerra nga Kryetari i	Në fund të çdo muaji

	Komunës, në MAPL për vlerësim të ligjshmërisë së të njëjtave.	
15	Ekspedimi me kohë i të gjitha vendimeve, rregulloreve, rekomandimeve e akteve tjera brenda institucioneve komunale, me qëllim të implementimit të tyre.	Detyrë permanente
16	Bashkëpunimi brenda institucioneve komunale dhe me organet qeveritare dhe ministritë tjera të linjës, në funksion të mbarëvajtjes së funksionimit sa më të mirë të organeve komunale.	Detyrë permanente
17	Mirëmbajtja e aparaturës-projekt i MAPL-s, për teleprezencë të anëtarëve të Kuvendit për monitorim-përcjellje të seancave të KK-s nga monitoruesit e MAPL-s,	Detyrë permanente
18	Instalimi i pajisjeve për përcjelljen direkte të seancave të Kuvendit të Komunës së Gjilanit jashtë sallës për mbajtjen e seancave, me qëllim të rritjes së transparencës dhe përcjellja e tyre nga ana e qytetarëve	Qershor 2019
19	Punë dhe aktivitetet të tjera të parapara me Planin e punës të kuvendit për vitin 2019.	Detyrë permanente
20	Botimi i gjitha vendimeve të miratuara nga KK-gjatë vitit 2011-2018 (shqip dhe serbisht)	Qershor 2019
21	Botimi i procesverbaleve nga seancat e KK-s për vitin 2009-2018	Qershor 2019

## KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI - KKSBB

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i themeluar në vitin 2009 më qëllim të dhënies së kontributit në përmirësimin e sigurisë publike në bashkësi për të gjithë qytetarët.

KKSBB ka një qasje të gjerë në ofrimin e sigurisë si dhe përgjegjësinë për krijimin e një mjedisi të sigurve dhe jetë të qetë për të gjitha komunitetet që jetojnë në komunë.

Që nga formimi i KKSBB –ës në bazë të udhëzimeve administrative nga ministritë përkatëse Komuna e Gjilanit ka luajtur dhe luan një rol të rëndësishëm në zbatimin e politikave të sigurisë të cilat dalin nga udhëzimet administrative, zyra e kryetarit dhe kuvendi komunal, duke bashkëpunuar me Policinë e Kosovës dhe me të gjitha subjektet tjera për të siguruar një ambient të qetë.

Objektivat e angazhimit të KKSBB –ës në Komunën e Gjilanit në vitin kalendarik 2019:

1. KKSBB, do të angazhohet në rritjen e vetëdijesimit të qytetarëve për identifikimin e krimeve, parregullive, dhe sjelljeve të dhunshme ndaj qytetarëve( Detyrë e përhershme);
2. Në ndërtimin e rritjes së besimit në mes të policisë dhe qytetarëve, ndërtimit të partneritetit, do të ndërmerren iniciativa të përbashkëta, për zgjedhjen e problemeve në bashkësi;
3. Vazhdimi i aktiviteteve nga viti kaluar në forcimin e tolerancës fetare si dhe avancimin e bashkëpunimit të këshillave fetare që jetojnë dhe veprojnë në komunë, do të bëhet përpjekje që ky aktivitet të jetë konkret, modalitetet e bashkëpunimit të definohen në takimet e rregullta në mes të krerëve fetare. KKSBB do të jetë shtytës i këtij bashkëpunimi me qëllim që të rritet besimi dhe më i madhe ndër fetar, (aktivitet i përhershëm);
4. Angazhimi i anëtarëve të KKSBB –ës në përfaqësimin dhe shprehjen e shqetësimeve të Qytetarëve për çështjet e krimit dhe çështjet e tjera do të jetë prioritet i shqetësimeve të anëtarëve të KKSBB –ës, ( Aktivitet i përhershëm) ;
5. Angazhimi i KKSBB –ës kundër dukurive negative, drogës, huliganizmit, trafikimit me qenie njerëzore, dhunës ndaj gruas, dhunës në familje, do të zhvillohet në bashkëpunim me gjitha organet e sigurisë: Policisë, Drejtorive të shkollave, Këshillit të Prindërve, Organizatave Rinore dhe Organizatave Joqeveritare, ( aktivitet i përhershëm);
6. Angazhimi i anëtarëve të KKSBB –ës në luftë kundër çdo ekstremizmi: fetar, etnik, gjinor, racor do të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës, Bashkësitë Fetare, Drejtorit e Shkollave, Mekanizmit kundër Ekstremizmit si dhe organeve të tjera komunale ( Aktivitet i përhershëm);
7. KKSBB do të inkurajojë policinë që të rrit prezencën, duke rritur patrullimet në të gjitha lokalitetet si do mos gjatë orëve të nartës në qytete dhe fshatra me qëllim të parandalimit të vjedhjeve dhe dukurive tjera negative ( aktivitet i përhershëm);
8. KKSBB në bashkëpunim me Policinë, Këshillat Lokale EVSB ( Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi), të rrisin interesimin me përcjelljen e situatës së sigurisë në

- komunë, bashkëpunojnë me qytetarët në ruajtën e rendit, qetësisë publike, në mbrojtjen e pronës dhe lirin e lëvizjes për të gjithë, ( aktivitet i përhershëm);
9. KKSBB në bashkëpunim e Drejtorinë e Arsimit, drejtorit e shkollave, këshillat e prindërve, të shqyrtojnë mënyrën e organizimit të ekskurzioneve të nxënësve dhe të ndër marrin masa që këto ekskurzionet të zhvillohen sipas plan programeve të Ministrisë së Arsimit dhe vet shkollave, gjithashtu këto organe të angazhohen maksimalisht në rritjen e cilësisë së arsimimit dhe edukimit, të pengojnë depërtimin politikës dhe dukurive tjera negative tek nxënësit, ( aktivitet i përhershëm);
  10. Qenet endacak janë bërë problem për tërë Kosovën, me këtë problem ballafaqohet edhe komuna e jonë. KKSBB do të iniciojë një bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë për trajtim të geneve endacak më qëllim të parandalimit, rrezikimit të jetës së qytetarëve e sidomos fëmijëve, ( aktivitet i përhershëm);
  11. Duke pas parasysh rritjen e numrit të automjeteve në komunikacion, rritjen e fatkeqësisë, rritjen e humbjes të jetës së njerëzve, rrezikimin e shëndetit të qytetarëve, dëmeve materiale, ndotjes së ajrit. KKSBB në bashkëpunim me Policinë, Inspektionin dhe rritjes së vetëdijes së qytetarëve, të rrisin kontrollin si dhe të sanksionojnë shkelësit e rregullave dhe ligjit, të shfrytëzojnë vendosjen e kamerave me qëllim identifikimi të kundërvajtësve, (aktivitet i përhershëm);
  12. KKSBB do të iniciojë bashkëpunim me të gjitha organet komunale, policinë e Kosovës, FSK-në, Mekanizmin kundër ekstremizmit, Organizatat Joqeveritare, OSBE, UNDP, Komunitetin Fetar, Komunitat e Kosovës, si dhe do të shqyrtojë mundësinë e bashkëpunimit me vendet fqinje ku jetojnë komunitetet me etni të ndryshme, me qëllim të shkëmbimit të përvojave.
  13. Përveç këtyre temave, KKSBB do të angazhohet edhe në shqyrtimin e çështjeve tjera në interes të qytetarëve si dhe detyrave që dalin nga zyra e kryetarit dhe kuvendi komunal, ( aktivitet i përhershëm);
  14. KKSBB në afat sa më të shkurt do të përpiloj projekte konkrete për realizimin e të cilave kërkohet edhe implikim financiar dhe do të kërkojë nga kryetari dhe kuvendi komunal për realizimin e këtyre projekteve.

## MEKANIZMI KOORDINUES KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

Bazuar në mandatin që ka, këto janë objektivat strategjike dhe aktivitetet përkatëse të Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje për vitin 2019:

Objektivi strategjik 1: Zvogëlimi i qëndrimeve paragjyquese dhe i sjelljeve që e mbështesin dhunën në familje, nëpërmjet informimit, edukimit, dhe vetëdijësimit të vazhdueshëm të profesionistëve, komuniteteve dhe shoqërisë. INDIKATORI 1: 30% (2018), 60% (2019) dhe 100% (2020) e nxënësve/studentëve dhe mësimdhënësve në institucionet arsimore të infomuar lidhur me dhunën në familje. INDIKATORI 2: 30% (2018), 500% (2019) dhe 700% (2020) e popullsisë të infomuar lidhur me dhunën në familje.					
Nr.	Aktivitetet	Veprimet	Stafi udhëheqës & mbështetës	Afati i zbatimit	Kosto
1.	Informimi i publikut për legjislacionin në fuqi, mbrojtjen që ofrohet, institucionet përkatëse, pasojat duke përfshi ato në rast të mos respektimit të urdhërit mbrojtës	1.1 Hartimi dhe printimi i fletëpalosjes (shërbimet, pasojat për kryesit të dhunës; pasojat nga moszbatimi i urdhërit mbrojtës)-dizajnimi dhe printimi 1.2 Organizimi i marshit (Përgatitja e Panos për marshin, Shtypja e maicave për pjesëmarrësit) 1.3 Organizimi i emisioneve ne media	MKKDHF DSHMS DKA NJDNJ Strehimorja	TM1 2019	1.1. 500€ 1.2. 300€ 1.3 Pa kosto <b>Total: 800.00€</b>
2.	Sesione informuese me komunitet per ceshtje te dhunes ne familje, të mbajtur nga anëtarët e MKKDHF.	1.Mbajtja e kater takimeve/sesione informuese	MKKDHF	TM1/2019 TM2/2019 TM3/ 2019 TM4 /2019	1. 5x120€ =600€ <b>Total 600.00€</b>
3.	Sesione informuese për nxënës dhe arsimtarë, nga anëtarët e Mekanizmit koordinues	1. Mbajtja e takimeve/sesione informuese me nxënës dhe mësimdhënës të shkollave të mesme të ulëta (6-9) dhe të mesme të larta (10-12) 1.2 Dizajni i postereve 1.3 Posteret per shkolla dhe institucione te tjera	MKKDHF	TM1 TM2 TM3 TM4	1. Pa kosto 1.2 50€ 1.3 40x0.40=16€ <b>Total 66.00€</b>
4.	Mbajtja esesioneve infomuese rreth dhunës në familje	Mbajtja e ligjëratave me studentet e UPGJ dhe Kolegjeve Private( tri takime ne vit)	MKKDHF Qendra Rinore UKZ dhe Kolegjet Private	TM1 TM2 TM4	1. Pa kosto
<b>Totali i shpenzimeve per vitin 2019</b>					<b>1.466.00€</b>

familje. INDIKATORI 1: 50% (2019); e viktimave të dhunës që kanë nevojë u ofrohet banim i qëndrueshëm (banim social ose mbulim i qirasë); INDIKATORI 2: 20% (2019); e viktimave të dhunës ndërmjetësohen në punësim nga ZP; INDIKATORI 3: 30% (2019); të viktimave të dhunës marrin pjesë në trajnime profesionale; INDIKATORI 4: 20% (2019); e viktimave të dhunës përfitojnë nga masat aktive të punësimit; INDIKATORI 5: 20% (2019); e viktimave të dhunës përfitojnë mbështetje në bujqësi ose përfitojnë grante për vetëpunësim; INDIKATORI 6: Strehimorja ka buxhet të qëndrueshëm.

Nr.	Aktivitetet	Veprimet	Stafi udhëheqës & mbështetës	Afati i zbatimit	Kosto
1.	Përkrahja e strehimoreve me buxhet vjetor	1.Ndarja e buxhetit 1.1 Komuna 5.000€ 1.2 MPMS 25.000€ 1.3 Donatoret 20.000€	Komuna MPMS Donatoret	Ne vazhdimësi	1. 5.000€ 2. 25.000€ 3. 20.000€ <b>Total =50.000.00€</b>
2.	Mbulimi i shpenzimeve emergjente për akterët që mirren direkt me rastet e DHF	Ndarja e buxhetit( 50 rasteve nga 5€ )	Komuna	Ne vazhdimësi	1. 50x5 = 250.00€
3.	Sigurimi i strehimit afatgjatë për viktimat nga DHF	1.1Plotësimi i rregulores për ofrimin e pikëve shtesë për rastet e dhunës në familje 1.2 Ofrimi i banimit social për rastet e DHF 1.3 Mbulimi i shpenzimeve të qirasë për të mbijetuarat nga DHF	MKKDHF Komuna		1.1 pa kosto 1.2 pa kosto 1.3 20x100= 2.000.00€
4.	Ofrimi i trajnimeve profesionale në QAP-a	1. Ofrimi i trajnimeve( 20 raste ne vit)	QAP	Ne vazhdimësi	
5.	Ndërmjetësimi në punësim nga ZP	1. Ndërmjetësimi në punësim ( 5 raste ne vite)	ZP Strehimorja	Ne vazhdimësi	1. Pa kosto
6.	Ofrimi i granteve për ndërmarrësi	1.Ofrimi i granteve( 10 grante per 10 raste nga 3.000.00€)	Donatoret		1. 30.000.00€
7.	Subvencionimi në bujqësi	1.Subvencionimi në bujqësi( 3 viktima te dhunes ne familje te perfitojne subvencione ne vite)	Drejtorati i Bujqsis		1. 3x500= 1.500.00€
8.	Punësimi përmes subvencionimit në pagë	1.Subvencionimi në page( 5 viktima te dhunes ne familje perfitues nga subvencionimi ne page x900€)	Donatoret permes ZP& Strehimorja		1. 5x 900= 4.500.00€
<b>Totali i shpenzimeve per vitin 2019</b>					<b>88.250.00€</b>

## MEKANIZMI REFERUES

Nr.	AKTIVITETI	AFATI KOHOR	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONI MBËSHTETËS
1	Mbajtja e takimeve me kryetarë të fshatrave të cënueshme nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm.		MR dhe KK	
2	Krijimi i aktiviteteve të ndryshme me komunitetin e OJQ të grave, organizatave rinore dhe forumet e grave të partive politike, komuniteti i biznesit etj, për t'i informuar rreth punës së policisë dhe mekanizmit referues, për mundësitë e bashkëpunimit në mënyrë që të ngritët besimi dhe parandalimi kundër radikalizmit dhe ekstremizmit.		MR dhe KK	
3	Organizimi i aktiviteteve që promovojnë rolin proaktiv të vajzave dhe grave si aktor kyç në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, nëpër fshatra te cënueshme.		MR dhe KK	
4	Organizimi dhe promovimi i aktiviteteve shkollore, nëpër fshatra (me prioritet në zonat e izoluara rurale)		MR dhe KK	
5	Organizimi i takimeve mes Mekanizmit Referues dhe këshillit të mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve rreth rolit të tyre në raportimin e rasteve tek mekanizmi referues.		MR dhe KK	
6	Mbështetja e aktiviteteve shkollore (sportive, kulturore) dhe përfshirjen e grupeve të marginalizuara në këto aktivitete përmes DKRS-se.		MR dhe KK	
7	Prezantimi i planit të veprimit të MR dhe rolit e tij në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që shpie ne terrorizëm.		MR dhe KK	
8	Fushata rreth Mekanizmit përmes fletpalosjeve		MR dhe KK	
9	Trajtimi i rasteve dhe monitorimi i tyre		MR dhe KK	

	nga Mekanizmi Referues			
10	Mbledhjet e rregullta të Mekanizmit Referues, janë gjithsej 12, ku çdo mbledhje mbahet të mërkuren e parë të muajit		MR dhe KK	

Mekanizmi Referues për Parandalim të Ekstremizmit të Dhunshëm që shpije në Terrorizëm, përveç vizitave dhe takimeve të ndryshme gjatë vitit në lidhje me fushëveprimtarinë e vet, parasheh edhe këto aktivitete për 2019:

Ju faleminderit

Lutfi Haziri, Kryetar